



Republike e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opštine Vučitrn / Municipality Vushtrri
Kryetari i Komunës – Precednik Opštine – Municipal Mayor



LIBRI I PROCESIVE
PËR
MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE
PUBLIKE

14 JANAR 2019

TABELA E PËRMBAJTJES









SHKURTESAT	4
LEGJENDA	5
HYRJE	6
I. Procesi i Buxhetit Komunal	8
1. Procesi i Buxhetit Komunal: Të dhënat e Përgjithshme	9
2. Procesi i Buxhetit Komunal: Procesi në Detaj	11
3. Procesi i Buxhetit Komunal: Lista e Rreziqeve	26
4. Procesi i Buxhetit Komunal: Diagrami i Procesit	34
II. Procesi i Menaxhimit të Pagave	39
1. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Të Dhënat e Përgjithshme	40
2. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Procesi në Detaj	41
3. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Lista e Rreziqeve	54
4. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Diagrami i Procesit	62
III. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta	66
1. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Të Dhënat e Përgjithshme	67
2. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Procesi në Detaj	69
3. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Lista e Rreziqeve	79
4. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Diagrami i Procesit	87
IV. Procesi i shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime	90
1. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Të dhënat e Përgjithshme	91
2. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Procesi Në Detaj	94
3. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Lista e Rreziqeve	116
4. Procesi i Shpenzimeve: Mallra dhe Shërbime: Diagrami i Procesit	124
V. Procesi i Shpenzimeve - Avance dhe Paraja e Imët	129
1. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Të Dhënat e Përgjithshme	130
2. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Procesi në Detaj	131
3. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Lista e Rreziqeve	140
4. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Diagrami i Procesit	146
VI. Procesi i Shpenzimeve - Udhëtimet Zyrtare	148
1. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Të Dhënat e Përgjithshme	149
2. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Procesi në Detaj	150
3. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Lista e Rreziqeve	157
4. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Diagrami i Procesit	163
VII. Procesi i shpenzimeve - Komunalitë	165
1. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Të Dhënat e Përgjithshme	166
2. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Procesi Në Detaj	168
3. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Lista e Rreziqeve	177
4. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Diagrami i Procesit	182
VIII.	184
	Procesi i Shpenzimeve - Subvencione dhe Transfere
1. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Të Dhënat e Përgjithshme	185
2. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Procesi në Detaj	187
3. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Lista e Rreziqeve	203
4. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Diagrami i Procesit	211
IX. Procesi i shpenzimeve - Investimet Kapitale	214
1. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Të Dhënat e Përgjithshme	215
2. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Procesi në Detaj	218
3. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Lista e Rreziqeve	240
4. Nën Procesi i menaxhimit të pasurive mbi 1,000€ dhe nën 1,000€ : Lista e Rreziqeve	252
5. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Diagrami i Procesit	264
X. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale	269
1. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Të Dhënat e Përgjithshme	270
2. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Procesi në Detaj	273
3. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Diagrami i Procesit	312
XI. Procesi i Menaxhimit të Projekteve	314
1. Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Të Dhënat e Përgjithshme	315
2. Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Procesi në Detaj	317
3. Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Lista e Rreziqeve	327

4.	Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Diagrami i Procesit	334
XII.	Procesi i Prokurimit	336
1.	Procesi i Prokurimit: Të Dhënat e Përgjithshme	337
2.	Procesi i Prokurimit: Procesi në Detaj	338
3.	Procesi i Prokurimit: Lista e Rreziqeve	356
4.	Procesi i Prokurimit: Diagram i Procesit	367
XIII.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave	371
1.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Të Dhënat e Përgjithshme	372
2.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Procesi në Detaj	373
3.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Lista e Rreziqeve	383
4.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Diagrami i Procesit	391

SHKURTESAT

AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
ATK	Administrata Tatimore i Kosovës
BDK	Bordi i Drejtorëve në Komunë
BNJ	Burimet Njerëzore
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
DNPDF	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve
DPT	Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit
FDHLP	Formulari I të Dhënave të Listës së Pagave
KAB	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KK	Kuvendi Komunal
KMC	Komision për Monitorimin e Cilësisë
KPF	Komiteti për Politike dhe Financa
KPK	Komiteti për Komunitete
KPM	Komisioni i Pranimit të Materialit
KPPTP	Komisioni për Pranim të Përkohshëm Teknik të Punimeve
LLVTh	Llogaria e Vetme e Thesarit
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MEK	Menaxheri i Ekzekutimit të Kontratës
MEP	Menaxheri i Ekzekutimit të Projektit
MEU	Mbikëqyrësi i Ekzekutimit të Urdhërësës
MF	Ministria e Financave
NJQH	Njësia Qendrore Harmonizuese e Kosovës
OE	Operatori Ekonomik
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PIP	Projekti i Investimeve Publike
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHQ	Qendra për Shërbime me Qytetarë
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
SIP	Sistemi Informativ i Pagave
SMVP	Sistemi Informativ i Vijueshmërisë në Punë
SZHMB	Sistemi për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

LEGJENDA



HYRJE

Ky dokument përbën një përmbledhje të proceseve kryesore të cilat kanë implikime në hallkat e kontrollit dhe ekzekutimit financiar në komuna në Kosovë. Proceset e poshtëshënuara mbështeten në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale. Libri i Proceseve synon të sqarojë dhe konsolidojë procedurat që duhet ndjekur për të siguruar kontroll të rregullsisë dhe cilësisë në procesin e buxhetimi dhe ekzekutimit të tij.

Qëllimi

Libri i Proceseve përbën një përmbledhje të proceseve të cilat qoftë në tërësi apo pjesërisht ndikojnë në performancën, mbikëqyrjen dhe rregullsinë financiare të Komunave. Ky libër vjen si rezultat i iniciativës të Njësisë Qendrore Harmonizuese të Ministrisë së Financave për të inkurajuar draftimin e proceseve në secilën organizatë buxhetore me qëllim të thjeshtëzimit të punës.

Përdorimi

Libri i Proceseve është një dokument i “gjallë” i cili duhet të rishikohet së paku në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikën e mira kombëtare dhe ndërkombëtare në proceset e përfshira në këtë libër. Ndryshimet në Libër të Proceseve duhet të bëhen rregullisht, dhe këto ndryshime si dhe versioni i përditësuar i dokumentit duhet t’u komunikohet të gjithë palëve të interesit.


Ky dokument gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësisë të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e proceseve gjithashtu ndihmon në përgatitjen e stafit ekzistues dhe atij të ri në mbarëvajtjen e detyrave të pozitave të tyre.

Struktura e librit

Ky dokument e shfleton secilin proces në tre mënyra. Për secilin proces, përdoruesit mund të gjejnë një përshkrim të përgjithshëm me informatat kryesore rreth pronarit të procesit (apo personit kryesor përgjegjës), ligjeve dhe rregulloreve që ndikojnë procesin, dokumenteve që duhen prodhuar, mjeteve informative të përfshira si dhe detaje të tjera. Pas përshkrimit, secili proces gjithashtu përmban hallkat e detajuara të procesit të cilat shpjegojnë veprimet, informatat, dokumentet, afatet dhe personat përgjegjës për secilën hallkë. Në fund, secili proces ka diagramin e vet i cili synon të lehtësojë kuptimin e procesit në tërësi si dhe ndjekjen e lehtë të procesit gjatë implementimit dhe mbikëqyrjes.

Në fund, ky libër përmban hallka të proceseve të cilat në mungesë të rregullativës specifike ligjore i janë përmbajtur praktikave të mira në mbarëvajtjen e proceseve. Këto hallka janë zhvilluar si rezultat i eksperiencës dhe praktikave të implementuara në komunën që ka zhvilluar këtë Libër të Proceseve.

Diagrami i Përgjithshëm i Integruar i Procesit të Planifikimit dhe Shpenzimit



I. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL

1. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i Buxhetit Komunal
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<TBD>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	<p>Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të përgatitjes së buxhetit komunal si dhe ndërlidhjes së procedurave komunale të përgatitjes së buxhetit me përgatitjen e buxhetit kombëtar.</p> <p>Procesi evidenton hallkat vendimmarrëse brenda Komunës sa i përket proceseve të planifikimit, draftimit, dëgjimeve publike dhe rishikimit pas qarkoreve qendrore buxhetore të buxhetit. Procesi gjithashtu evidenton proceset e komunikimit dhe bashkërendimit me Ministrinë e Financave për buxhetin e përgjithshëm kombëtar.</p>
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
Versioni:	V. 01/2018
Korniza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.
Pronari i Procesit:	1. Kryetari i Komunës
Palët e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Financave 2. Analisti/ja për Buxhet Komunal në Ministrinë e Financave 3. Kryetari i Komunës 4. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar Komunal 5. Drejtorët e Drejtorive Komunale 6. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) 7. Kuvendi Komunal dhe Kryesuesi
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB) 2. E-Mail 3. Ueb faqet e Ministrisë së Financave dhe Komunës 4. Programi i Investimeve Publike (PIP)
Dokumentet e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qarkorja e Parë Buxhetore 2. Qarkorja e Dytë Buxhetore 3. Qarkorja e Brendshme Komunale 4. Korniza Afatmesme e Buxhetit (KAB) 5. Projekt Buxheti 6. Lista e propozimeve dhe ideve nga dëgjimet publike 7. Vendimi i Kuvendit Komunal për aprovimin e Draft Buxhetit 8. Shkresa përcjellëse e Kryetarit të Komunës për dërgimin e buxhetit të aprovuar të Ministria e Financave

	9. Tabelat e buxhetit (4.1, 4.2 dhe 4.3) 10. Formularët e Shpenzimit të Departamenteve (PCF1, PCF2, PCF3, PCF4)
Ndërlidhja:	Nuk ka
Numri i hapave:	26

2. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: PROCESI NË DETAJ

Procesi i përgatitjes së buxhetit komunal						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Pranimi i qarkores së parë nga Ministria e Financave	<p>1.1 Qarkorja e Ministrisë së Financave pranohet nga zyra e Kryetarit të Komunës përmes postës elektronike (e-mail), Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF)/Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF). Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb faqen zyrtare të MF.</p> <p>1.2 DBF/ZKF përcjell qarkoren tek drejtorët e të gjitha drejtorive, udhëheqëit e programeve dhe tek të gjithë palët me interes përmes e-mailit dhe/ose në kopje fizike.</p>	<p>1. Zyra e Kryetarit</p> <p>2. DBF/ZKF</p>	Deri me 15 Maj	1. Qarkorja në format Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

2	Hartimi i qarkores së brendshme komunale	<p>2.1 Kryetari i Komunës e dërgon qarkoren tek Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF) / Zyrtari Kryesor Financiar</p> <div data-bbox="613 331 1075 587" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p style="text-align: center;">KUTIA 1</p> <p>Qarkorja e brendshme përcakton, qëllimet, objektivat, afatet dhe kërkesat nga drejtorët e drejtorive për shpenzimet për 3 vitet e ardhshme</p> </div> <p>(ZKF).</p> <p>2.2 DBF/ZKF siguron zhvillimin e qarkores së brendshme të komunës (në nivel të programeve/nënprogrameve dhe kategorive të shpenzimeve).</p> <p>2.2.1 Qarkoren e brendshme e përgatitë (vendosja e të dhënave në tabela të buxhetit) DBF/ZKF. Kjo bëhet bazuar në informatat financiare nga vitet paraprake.</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Drejtorët e Drejtorisë Përkatëse</p>	15-22 Maj	1. Qarkorja e Brendshme Komunale në format Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
3	Shpërndarja/dorëzimi i qarkores së brendshme komunale	<p>3.1 DBF/ZKF e shpërndan qarkoren e brendshme buxhetore tek drejtorët e të gjitha drejtorive dhe udhëheqësit e programeve.</p> <p>3.2 Drejtorët e drejtorive e shpërndajnë qarkoren e brendshme te:</p>	<p>1. DBF/ZKF</p> <p>2. Drejtorët e Drejtorive Komunale dhe udhëheqësit e</p>	22 Maj	1. Qarkorja e Brendshme Komunale	NA

		<ul style="list-style-type: none"> • Udhëheqësit e njësive në kuadër të drejtorive të tyre; • Drejtorët e shkollave dhe çerdheve; dhe • Udhëheqësit e institucioneve shëndetësore. 	njësive/program eve			
4	Paraqitja e kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet tek DBF/ZKF për përgatitje të KAB	<p>4.1 Pas pranimit të qarkores së brendshme, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e programeve fillojnë me përgatitjen e kërkesave buxhetore.</p> <p>4.2 Drejtorët e drejtorive diskutojnë kërkesat buxhetore me stafin e tyre.</p> <p>4.3 Drejtorët e drejtorive dërgojnë propozimet buxhetore tek DBF/ZKF.</p>	<p>1. Drejtorët e drejtorive dhe stafi i tyre</p> <p>2. Udhëheqësit e njësive</p> <p>3. DBF/ZKF</p>	5 Qershor	1. Formulari i nënshkruar nga drejtorët e drejtorive	NA
5	Dëgjimet e hershme buxhetore [OPSIONALE]	5.1 Kryesuesi i Komitetit për Politike dhe Financa, në bashkëpunim me DBF/ZKF, drejtorët e drejtorive mbajnë dëgjime të hershme publike para hartimit të Kornizës Afatmesme Komunale të Buxhetit.	<p>1. Kryesuesi Kuvendit</p> <p>2. DBF/ZKF</p>	Fund i Majit	<p>1. Njoftimi për dëgjime buxhetore</p> <p>2. Përmbledhja e dëgjimeve të hershme buxhetore.</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e</p>

						Republikës së Kosovës).
6	Hartimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB)	6.1 Bazuar në strategjinë zhvillimore komunale, propozimet buxhetore të drejtorive dhe programeve si dhe inputet nga dëgjimet publike (brenda kufijve buxhetor), Kryetari i Komunës në bashkëpunim me DBF/ZKF, dhe drejtorët e drejtorive hartojnë draft Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).	1. Kryetari i Komunës 2. Drejtorët e drejtorive 3. DBF/ZKF	10 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
7	Prezantimi i draft KAB në Komitetin për Politikë dhe Financa	7.1 Kryetari i komunës e aprovon draft KAB-it. 7.2 Pas aprovimit, Kryetari së bashku me DBF/ZKF prezanton draft KAB në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF).	1. Kryetari i Komunës 2. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) 3. Komiteti për Komunitete (KPK)	10-25 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal

						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
8	Inputet nga komitetet	8.1 Propozim ndryshimet eventuale të komiteteve plotësohen nga DBF/ZKF në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive përkatëse.	1. Kryetari i Komunës 2. DBF/ZKF 3. Drejtorët e drejtorive	25-30 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
9	KAB në Kuvend Komunal	9.1 Draft KAB dërgohet në Kuvend Komunal për shqyrtim dhe aprovim. 9.2 KAB aprovohet nga Kuvendi Komunal dhe vendimi për aprovim të KAB-it nënshkruhet nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal. 9.3 Nëse Kuvendi Komunal nuk aprovon dhe dorëzon buxhetin tek Ministria e Financave brenda afatit ligjor, atëherë, Ministri i Financave është i autorizuar që të përgatis propozim	1. Kryetari i Komunës 2. Kuvendi Komunal 3. Kryesuesi i Kuvendit Komunal	Deri më 30 Qershor	1. Vendimi i për aprovim KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e

		<p>buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore për komunën duke u bazuar por duke mos e tejkaluar buxhetin dhe ndarjet buxhetore të vitit aktual fiskal.</p> <p>9.4 Nëse deri më 1 Mars, Kuvendi Komunal përsëri dështon që të miratoj dhe dorëzoj në MF propozim buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore, atëherë asnjë shpenzim nuk duhet të bëhet nga ose në emër të komunës derisa kuvendi nuk e aprovon dhe dorëzon buxhetin në Ministri të Financave.</p>				<p>Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
10	Dorëzimi i KAB në MF	10.1 Kryetari i Komunës e dërgon KAB (të aprovuar nga Kuvendi Komunal) në MF.	1. DBF/ZKF	30 Qershor	1. KAB-i aprovuar	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

11	Pranimi i qarkores së dytë nga Ministria e Financave	<p>11.1 Dokumenti i Ministrisë së Financave pranohet në formë elektronike (e-mail) nga Kryetari i Komunës. Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb site të MF.</p> <div data-bbox="595 389 1070 660" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; text-align: center;"> <p>KUTIA 2</p> <p>Përderisa Qarkorja e parë përcakton kufijtë buxhetor, qarkorja e dytë specifikon se ku do të shpenzohet buxheti. Ministria e Financave mund të lëshojë më shumë se 1 qarkore</p> </div>	1. Kryetari i komunës	Nuk ka	Qarkorja e dytë buxhetore në Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
12	Hartimi i qarkores së dytë të brendshme të Komunës dhe shpërndarja e saj tek drejtorët e drejtorive	<p>12.1 Hartohet qarkorja e dytë e brendshme e komunës nga DBF/ZKF (përfshihen inputet nga diskutimet e brendshme nga drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e programeve).</p> <p>12.2 DBF/ZKF dërgojnë qarkoren e dytë të brendshme tek drejtorët dhe udhëheqësit e njëjësive për plotësim. Qarkorja përcakton kufijtë buxhetor për kategori të shpenzimeve.</p>	2. DBF/ZKF	Fundi i Korrikut	1. Qarkorja e Dytë Buxhetore	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e</p>

						Republikës së Kosovës).
13	Dëgjimet publike	13.1 Mbahen dëgjime publike me qytetarë me qëllim të diskutimit të Projektbuxhetit.	1. Kryesuesi i Kuvendit 2. DBF/ZKF	Muaji gusht	1. Projektbuxheti	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
14	Përgatitja e projekt buxhetit dhe kërkesave për ndarje buxhetore në nivel të drejtorive	14.1 Pas pranimit dhe shpërndarjes së qarkores së dytë të brendshme, drejtorët e drejtorive organizojnë diskutime brenda drejtorive për të diskutuar kërkesat buxhetore. 14.2 Drejtorët e drejtorive i dërgojnë kërkesat buxhetore tek DBF/ZKF.	1. DBF/ZKF 2. Drejtorët e drejtorive		Propozimet buxhetore (PCF1,2,3 dhe 4)	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal

						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
15	Kontrollimi i propozimeve buxhetore dhe kërkesave për ndarje buxhetore sipas qarkores së dytë	15.1 Kërkesat e drejtorive për ndarje buxhetore përkatëse diskutohen dhe dakordohen me Kryetarin e Komunës dhe DBF/ZKF.	1. Kryetari i Komunës 2. DBF/ZKF 3. Shefi i planifikimit të buxhetit		NA	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
16	Dorëzimi i projekt buxhetit dhe kërkesave për ndarje buxhetore në Kuvend Komunal	16.1 Projekt buxheti diskutohet nga Kryetari i Komunës dhe bordi i drejtorëve dhe i dërgohet sekretarisë së Kuvendit Komunal.	1. Drejtorët e drejtorive 2. Kryesuesi i Kuvendit komunal	Para 1 Shtatorit	Projekt buxheti në kopje	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e

						Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
17	Futja e të dhënave preliminare buxhetore në Sistemin për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit (SZHMB) dhe në Programin e Investimeve Publike (PIP)	17.1 Të dhënat buxhetore për të gjitha kategoritë e shpenzimeve futen në SZHMB dhe PIP nga zyrtarët e autorizuar. 17.2 Të gjitha këto të dhëna kontrollohen nga DBF/ZKF.	1. Zyrtarët e autorizuar 2. DBF/ZKF	Deri më 30 Shtator	1. Formularët e buxhetit të departamenteve nga SZHMB (PCF1,2,3 dhe 4) 2. Tabelat e buxhetit (4.1, 4.2, 4.3)	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
18	Dëgjimet publike shtesë	18.1 Mbahen dëgjime publike me qytetarë me qëllim të diskutimit të Projektbuxhetit me qytetarë.	1. DBF/ZKF 2. Kryesuesi i Kuvendit	1-12 Shtator	1. Përmbledhja e inputit nga dëgjimet publike	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

						2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
19	Shqyrtimi i kërkesave në KPF	19.1 Propozimet/idetë eventuale nga dëgjimet publike mund të dërgohen në KPF për shqyrtim.	1. KPF	1-12 Shtator	1. Propozimet/idetë nga dëgjimet publike	NA
20	Prezantimi në Kuvendin Komunal	20.1 Pas shqyrtimit të buxhetit në KPF, projekt buxheti prezantohet dhe diskutohet në Kuvendin Komunal.	1. Kryetari i Komunës	Deri 30 Shtator	1. Projekt buxheti	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
21	Korrigjime në dokumentin e buxhetit duke u bazuar në inputet e	21.1 Nëse ka kërkesa për ndryshime (nga dëgjimet publike/komitetet/Kuvendi Komunal), projekt buxheti kthehet tek Kryetari i Komunës dhe DBF/ZKF	1. Kryetari i Komunës	12-20 Shtator	1. Draft buxheti i korrigjuar	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike

	dëgjimeve/komiteteve/kuvendit	për korrigjimet plotësuese dhe vendosjen e tyre në SZHMB dhe PIP.				dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
22	Aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunal	22.1 Buxheti aprovet nga Kuvendi Komunal.	1. Kuvendi Komunal	Deri me 30 Shtator	1. Buxheti i aprovuar 2. Vendim i Kuvendit Komunal	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
23	Azhurnimi i buxhetit nëse ka pasur ndryshime	23.1 Nëse buxheti i aprovuar në kuvend ndryshon nga projekt buxheti,	1. Zyrtarët e autorizuar	Deri 30 Shtator	1. Buxheti i Aprovuar	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e

	gjatë aprovimit në Kuvend Komunal	ndryshimet vendosen në SZHMB dhe PIP nga zyrtarët e autorizuar.				<p>Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
24	Njoftimi i analistëve në MF dhe kontrolli final	<p>24.1 Drejtori për Buxhet dhe Financa/ZKF gjatë gjithë kohës dhe sipas nevojës konsultohet me analistët e buxhetit në Ministri të Financave për për asistencë gjatë hartimit të buxhetit.</p> <p>24.2 Nëse ka nevojë analisti i MF-së jep udhëzimet e nevojshme për komunën.</p>	<p>1. DBF/ZKF</p> <p>2. Analistët e buxhetit në MF</p>	Deri 30 Shtator	NA	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

25	Dorëzimi i Buxhetit në Ministrinë e Financave	<p>25.1 Buxheti i komunës (i aprovuar në kuvend dhe nënshkruar prej kryesuesit të kuvendit) dërgohet në MF.</p> <p>25.1.1 Bashkëngjitet shkresa përcjellëse nga Kryetari i Komunës për MF.</p> <p>25.1.2 Dorëzohen tabelat buxhetore të zhvilluara nga SMZHB dhe PIP.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tabela 4.1: Plani i ndarjes buxhetore të shpenzimeve. • Tabela 4.2: Financimi i projekteve kapitale. • Tabela 4.3: Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. • Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e buxhetit • Formulari i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator 	1. Kryetari i Komunës	30 shtator	<p>1. Dokumenti i buxhetit në kopje fizike dhe elektronike</p> <p>2. Shkresa përcjellëse</p> <p>3. Tabela 4.1</p> <p>4. Tabela 4.2</p> <p>5. Tabela 4.3</p> <p>6. Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e buxhetit</p> <p>7. Formulari i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
----	---	---	-----------------------	------------	---	--

26	Kontrolli final dhe aprovimi i buxhetit nga analistët e MF	<p>26.1 Analisti i buxhetit në MF bën kontrollin e fundit nëse buxheti është brenda kufijve të caktuar me qarkoren e dytë buxhetore në kategoritë ekonomike.</p> <p>26.2 Nëse ka ndonjë mospërputhje, buxheti kthehet mbrapa për korrigjim tek komuna</p> <p>26.3 Finalizimi i buxhetit komunal dhe përfshirja e tij në projektbuxhetin e përgjithshëm shtetëror dhe aprovimi në Qeverinë e Republikës së Kosovës.</p>	<p>1. Analistët e buxhetit</p> <p>MF</p>	<p>30 Shtator</p> <p>31 tetor</p>		<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
Fundi i procesit të përgatitjes së buxhetit komunal						

3. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: LISTA E RREZIQEVE

3.1 Mbivlerësimi/nënvlerësimi i kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet buxhetore

3.2 Buxhetet jo në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës

3.3 Buxheti jo gjithëpërfshirës i cili nuk adreson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve

3.4 Mos aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunal

	Numri i Referencës	3.1
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Financiar
	Nën procesi	Procesi i buxhetit komunal
	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	Mbivlerësimi/nënvlerësimi i kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet buxhetore
	Shkaku i Rrezikut	Nevoja të reja dhe rrethana të ndryshuara Mos vlerësimi i saktë i kostove të kërkesave buxhetore Mungesa e kapaciteteve në përgatitjen e buxhetit
	Ndikimi/Pasoja	Dështimi për të siguruar mjete buxhetore për të plotësuar kërkesat e departamenteve Drejtoritë dështojnë të përmbushin objektivat e tyre Buxhet i pa shpenzuar Mos realizimi i kërkesave dhe nevojave

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Anulimi i procedurave të blerjeve dhe nevoja për përsëritje të tyre Dështimi për të ofruar shërbime ndaj qytetarëve
	Masat ekzistuese të kontrollit	Qarkoret buxhetore të Ministrisë së Financave Qarkoret e brendshme buxhetore të komunës Koordinimi i procesit buxhetor nga Zyrtari Kryesor Financiar
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	4
	Pasoja (1-5)	2
	Rezultati	8
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të përshtatshme
	Veprimi	Zvogëlimi
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Trajnimi i stafit për rritjen e kapaciteteve planifikuese Kujdes i shtuar gjatë procesit të planifikimit Vlerësimi i kostove të kërkesave buxhetore bazuar me çmimet e tregut
	Forma e masave	Plan i trajnimit, hulumtim i tregut
	Burimet që kërkohen	Financiare, njerëzore
	Pronari i rrezikut	Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF) /Zyrtar i Kryesor Financiar (ZKF)
	Data e përfundimit	TM1 2019

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MAP, MF, MAPL
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

	Numri i Referencës	3.2
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Strategjik, Financiar
	Nën procesi	Procesi buxhetor komunal
	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	Buxhet jo në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës
	Shkaku i Rrezikut	Kuptimi i dobët i objektivave strategjike komunale nga stafi i përfshirë në proces të buxhetit Paraqitja e objektivave të reja dhe interesimi i menaxhmentit për financimin e projekteve ad-hoc jashtë fushave
	Ndikimi/Pasoja	Dështimi për të realizuar objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës Shpenzime jo efektive dhe mungesa e buxhetit për financimin e nevojave prioritare Dështimi për të përmbushur pritjet e qytetarëve
	Masat ekzistuese të kontrollit	Dokumentet dhe planet strategjike të komunës Korniza Afatmesme e Buxhetit

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Procesi i dëgjimeve buxhetore Monitorimi i procesit të buxhetit
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përdorimi i objektivave dhe prioriteteve strategjike të komunës të vendosura në dokumente strategjike dhe Kornizën Afatmesme të Buxhetit si bazë për buxhetim Përgatitja e KAB në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës si dhe përdorimi i KAB si dokument bazë gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor
	Forma e masave	Plan vjetor për përgatitje të buxhetit
	Burimet që kërkohen	Angazhim i stafit komunal
	Pronari i rrezikut	DBF/ZKF
	Data e përfundimit	TM1 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MF

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët
--	---------------------------------------	--------

	Numri i Referencës	3.3
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Strategjik, Operativ
	Nën procesi	Procesi i buxhetit komunal
	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	Buxheti jo gjithëpërfshirës i cili nuk adreson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve
	Shkaku i Rrezikut	Mos përfshirja e qytetarëve në procesin e përgatitjes së buxhetit Dështimi për të organizuar dëgjime publike apo pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në dëgjime buxhetore Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve nuk merren parasysh gjatë procesit buxhetor
	Ndikimi/Pasoja	Mos adresimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve Humbja e besimit të qytetarëve ndaj administratës komunale Rënie e interesit të qytetarëve për të paguar tatimet dhe taksat komunale
	Masat ekzistuese të kontrollit	Dëgjimet publike me qytetarët
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shitesë për trajtimin e rrezikut	Mbajtja e dëgjimeve të mjaftueshme publike me përfaqësuesit e të gjitha vendbanimeve Marrja në konsideratë e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve përfshirë të gjitha grupet marginalizuara gjatë procesit buxhetor. Qasje aktive në informimin e qytetarëve për pjesëmarrje në dëgjimet publike gjatë procesit buxhetor.
	Forma e masave	Komunikim dhe informim i qytetarëve
	Burimet që kërkohen	Angazhimi stafit
	Pronari i rrezikut	DBF/ZKF
	Data e përfundimit	TM2 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	Kuvendi Komunal – Komiteti për Politike dhe Financa Ministria e Financave
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I Ulët
	Numri i Referencës	3.4
IDEN TIFIKI MI I	Kategoria	Politik
	Nën procesi	N/A

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	Mos aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunal
	Shkaku i Rrezikut	Buxheti nuk përfaqëson nevojat dhe kërkesat e komunitetit që përfaqësojnë asamblistët Buxheti nuk siguron zhvillim në fushat dhe nevojat prioritare
	Ndikimi/Pasoja	Komuna dështon të realizojë të gjitha projektet kapitale të planifikuara etj. Përkrahje jo e mjaftueshme e ekzekutivit nga kuvendi komunal Objektivat e planit zhvillimor të komunës nuk arrihen dhe ka ngecje në zhvillim ekonomik Nevoja për përsëritje të procesit buxhetor
	Masat ekzistuese të kontrollit	Provizionet ligjore për afatet e aprovimit të buxhetit komunal Proceset e diskutimeve buxhetore komunale para aprovimit të buxhetit Rishikimi i projekt-buxhetit nga Komisioni për Financa
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	1
	Pasoja (1-5)	5
	Rezultati	5
	Prioriteti i rrezikut	I Ulët
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të përshtatshme
	Veprimi	Monitorim, shmangie


Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shitesë për trajtimin e rrezikut	Përgatitja e buxhetit duke ndjekur një proces gjithëpërfshirës dhe transparent që adreson pritjet e qytetarëve dhe nevojat e komunës për zhvillim Përfshirje e asamblistëve gjatë procesit të buxhetit veçanërisht gjatë takimeve me qytetarë dhe gjatë dëgjimeve buxhetore.
	Forma e masave	Plan i veprimit
	Burimet që kërkohen	Burime njerëzore
	Pronari i rrezikut	Kryetari i Komunës
	Data e përfundimit	TM2 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	Kuvendi Komunal
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I Ulët


Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

4. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: DIAGRAMI I PROCESIT










Buxheti ka mospërputhje me kufinjte buxhetor dhe nuk aprovohet



II. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE

1. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i Menaxhimit të Pagave
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<DATA>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi përshkruan procedurat emenaxhimit të pagave në komunë përfshirë fazat si punësimi i punonjësve të rinj, koha dhe vijueshmëria, menaxhimi i listës së pagave, kalkulimi i pagave, pagesat, etj.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Komuna
Versioni:	V. 01/2018
Korniza ligjore:	
Pronari i Procesit:	1. Kryetari i Komunës 2. Menaxheri i Personelit
Palët e përfshira në proces:	1. Kryetari i Komunës 2. Punonjësit 3. Menaxheri i BNJ 4. Drejtorët e Drejtorive Përkatëse 5. Thesari (divizioni i pagave) 6. Zyrtari i shpenzimeve 7. Ministria e Administratës Publike (MAP) 8. Banka Qendrore e Kosovës (BQK)
Sistemet e TI të përfshira në proces:	1. E-Mail 2. SIMBNJ 3. SMVP
Dokumentet e përfshira në proces:	1. Formulari standard i aplikimit 2. Akt emërimi 3. Kontrata 4. Dokumenti elektronik për punonjës të rinj 5. Kartela Magnetike për qasje në punë 6. Listat e vijueshmërisë 7. Urdhëresa për punë jashtë orarit 8. Formulari i aprovimit të orëve të punuara jashtë orarit të rregullt 9. Raportet e vijueshmërisë në punë 10. Dokumentet mbështetëse (raportet mjekësore, etj.) 11. Lista elektronike e punonjësve 12. Urdhri për pagesë 13. Urdhërpagesa
Ndërlidhja:	Procesi i Buxhetit
Numri i hapave:	26

2. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: PROCESI NË DETAJ

Procesi i Menaxhimit të Pagave						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet e gjeneruara	Sistemet
Nën-Procesi: Krijimi (angazhimi) i punonjësve të rinj						
1.	Regjistrimi i të dhënave të punonjësve të rinj në sistem të BNJ	<p>1.1 Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësit të rinj, çdo punonjës i sapo punësuar ka plotësuar të dhënat e tij/saj personale në formatin standard të aplikacionit të BNJ (emri, mbiemri, datëlindja, numrin e letërnjoftimit, vendndodhjen, kombësinë, statusin civil, adresën, edukimi, profesioni, kualifikimet etj.)</p> <p>1.2 Të dhënat e plotësuara nga punonjësit dërgohen tek BNJ dhe inkorporohen ne SIMBNJ.</p>	1. Çdo punonjës	Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit	<p>1. Të dhënat individuale dhe komponentët e pagës</p> <p>2. Aplikimi për transferin bankar</p> <p>3. Formulari standard i aplikimit</p>	Në letër
2.	Përgatitja e Akt emërimit nga Burimet Njerëzore	2.1 Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësit të rinj, çdo punonjës i sapo emëruar plotëson të dhënat e tij/saj personale në formatin standard të BNJ (emri, mbiemri, datëlindja, numrin e letërnjoftimit, vendndodhjen, kombësinë, statusin	1. Menaxheri i BNJ	Nuk ka	1. Akt emërimit e punonjësit të ri	Në letër

		<p>civil, adresën, edukimi, profesioni, kualifikimet etj.)</p> <p>2.2 Menaxheri i BNP përgatitë akt emërimit të punonjësit të ri në përputhje me katalogun e vendeve të punës dhe shpalljen.</p> <p>2.3 Menaxheri i BNP e dërgon letrën e akt emërimit tek Kryetari i Komunës për nënshkrim</p>				
3.	Nënshkrimi i kontratës me punonjësin e ri	<p>3.1 Kryetari i komunës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nënshkruan akt emërimit; • Nënshkruan kontratën e punës me punonjësin e ri; dhe 	1. Kryetari i Komunës	Brenda 30 ditëve pas rekrutimit	<p>1. Akt emërimi i punonjësit të ri</p> <p>2. Kontrata</p>	<p>1. Në letër</p> <p>2. SIMBNJ</p>
4.	Dërgimi i dokumentacionit të punonjësve të rinj në MAP dhe regjistrimi i tyre në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ)	<p>4.1 Zyrtari i BNP:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Skanon të gjitha dokumentet dhe i regjistron në SIMBNJ, ndërsa kopjet e dokumenteve të nevojshme i dërgon tek zyrtarët në MAP; dhe • Për qëllime të brendshme, krijon një bazë të thjeshtë të dhënash për punonjësit me informata si (emrin e institucionit, lokacionin, departamentin, emrin mbiemrin, diplomat e fituara, datëlindjen, 	<p>1. Zyrtari përgjegjës i BNP</p> <p>2. MAP</p>	Deri me datë 11 të muajit vijues	<p>1. Dokumentin elektronik për punonjës të rinj</p> <p>2. Formulari për punëtorë të rinj</p> <p>3. Dokumentet në kopje fizike dërgohen në MAP</p>	1. SIMBNJ

		pozitën dhe shkallën e gradën e pagës)				
Nën-procesi: Koha dhe vijueshmëria						
5.	Regjistrimi i punonjësve të rinj në Sistemin për Menaxhimin dhe Vijueshmërinë në Punë (SMVP)	5.1 Zyrtari i burimeve njerëzore informon departamentin e IT për stafin e ri 5.2 IT regjistron të dhënat personale të punonjësve të rinj në SMVP.	1. Zyrtari i BNJ	Nuk ka	1. Baza e të dhënave për vijueshmërinë në punë	SMVP
6.	Aprovimi i të dhënave për punonjësit e rinj në SMVP dhe krijimi i kartelës magnetike për regjistrimin e kohës	6.1 Menaxheri i BNJ i kontrollon dhe aprovon të dhënat e futura nga zyrtari i burimeve njerëzore në SMVP. 6.2 Menaxheri i BNJ krijon kartelën magnetike për regjistrim të vijueshmërisë dhe e pajis punonjësën e ri për qasje në vend të punës.	1. Zyrtari i BNJ	Nuk ka	1. Kartela magnetike	SMVP
7.	Regjistrimi manual i vijueshmërisë në punë (aty ku nuk aplikohet sistemi SMVP – ku ka prishje)	7.1 Menaxheri i drejtorisë përkatëse përgatitë dhe printon listat e hyrje daljes në baza ditore 7.2 Menaxheri i drejtorisë përkatëse i vendosë listat në vend të përshtatshëm për nënshkrim.	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse 1. Çdo punonjës	NA	1. Lista e vijueshmërisë	Letër

		<ul style="list-style-type: none"> • Në mëngjes listat janë në dispozicion për nënshkrim deri në 15 minuta pas fillimit të orarit të punës. • Pas dite, listat janë në dispozicion për nënshkrim 10 para përfundimit të orarit të punës. • Në rast të ardhjes me vonesë ose daljes pas orarit të punës, vendoset ora e sakët e ardhjes/daljes nga puna. <p>7.3 Drejtori i drejtorisë përkatëse i dërgon listat e nënshkruara të vijueshmërisë në punë tek BNJ.</p>				
8.	Evidentimi i nevojës për punë jashtë orarit dhe para autorizimi	<p>8.1 Drejtori i drejtorisë përkatëse evidenton nevojën dhe pajtohet për punë jashtë orarit.</p> <p>8.2 Drejtori i drejtorisë përkatëse autorizon kryerjen e punëve jashtë orarit përmes plotësimit të formularit Urdhëresa për Punë Jashtë Orarit”</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Drejtori i drejtorisë përkatëse</p>	NA	1.Urdhëresa për Punë Jashtë Orarit	Në letër
9.	Konfirmimi i punës jashtë orarit	<p>9.1 Në rast të orëve shtesë jashtë orari të kryera nga stafi, drejtori i drejtorisë kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse orët shtesë të kryera bazohen në urdhëresën për punë shtesë jashtë orarit; dhe 	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse/udhëheqësi i njësisë	Pasi puna të kryhet	1. Formulari i aprovimit për orët e punuara jashtë orarit të punës	Në letër

		<ul style="list-style-type: none"> • Nëse puna zbatohet në përputhje me urdhëresën; <p>9.2 Drejtori i drejtorisë përgatitë kërkesë zyrtare për aprovim të punëve të kryera jashtë orarit nga Kryetari i Komunës.</p>				
10.	Raportimi i vijueshmërisë	10.1 Sipas kërkesës, menaxheri i BNJ gjeneron raporte mujore për vijueshmërinë e përditshme të çdo punonjësi të grupuara në drejtori. Raportet gjenerohen në SMVP ose listave të nënshkruara të vijueshmërisë (ku nuk përdoret SMVP).	1. Menaxheri i BNJ	NA	1. Raportet e gjeneruara të vijueshmërisë	1. SMVP
11.	Konfirmimi i vijueshmërisë	<p>11.1 Drejtori i drejtorisë përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrollon kohën e vijueshmërisë për secilin punonjës; • Siguron dokumentin e arsytimit mbështetës në rast të mungesës së punonjësit që ka nën mbikëqyrje; dhe • Trajton kërkesat e stafit të tij/saj për ri kalkulim të pagave nga muaji paraprak; <p>11.2 Punonjësi konfirmon ose jo ndryshimet e kohës ose të prezencës</p>	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse	Brenda datës 5 së muajit aktual	<p>1. Lista e vijueshmërisë e nënshkruar;</p> <p>2. Dokumentet mbështetëse në rast të mungesës në punë (raporti mjekësor, etj.)</p> <p>3. Rishikimin e kalkulimeve, etj.</p>	E-mail

Nën-procesi: Menaxhimi i Listës së Pagave						
12.	Përgatitja e listës së pagave	<p>12.1 Zyrtari i burimeve njerëzore përgatitë të dhënat për listën e pagave përmes formularit për të dhënat për listën e pagave për secilin punonjës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kodin institucional dhe buxhetor; • Lokacionin; • Departamentin; • Emrin dhe mbiemrin e punonjësve • Datëlindjen; • Kodi i pagesës; • Pozita dhe kodi i pagesës; dhe • Koeficienti. 	1. Zyrtari përgjegjës i burimeve njerëzore	Deri me datë 10 të muajit	1. Formulari i të dhënave për listën e pagave për secilin punonjës	1. SIMBNJ
13.	Përfshirja e ndryshimeve dhe pagave retroaktive në listën e pagave	<p>13.1 Për ndryshimet gjatë muajit dhe pagesat retroaktive, zyrtari i BNJ:</p> <p>13.2 Kontrollon dokumentet e pranuar të cilat autorizojnë ndryshimet; dhe</p> <p>13.3 Përgatitë një dokument të veçantë me të dhënat shtesë lidhur me</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zërin e ndryshuar në FDHLP; 	1. Zyrtari i BNJ	Deri me datë 10 të muajit vijues	<p>1. Lista e ndryshimeve e krijuar nga zyrtari i BNJ</p> <p>2. Dokumentet mbështetëse</p> <p>(urdhri nga Kryetari i Komunës)</p>	1. Në letër

2. PROCESI I SHPENZIMEVE - MALLRA DHE SHËRBIME: PROCESI NË DETAJ

Procesi i shpenzimeve publike për Mallra dhe Shërbime						
Hapat	Aktivitetet	Aktivitetet e kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
Nën-procesi: Inicimi i shpenzimeve						
1.	Plani i rrjedhës së parasë	<p>1.1. Drejtorët e drejtorive së bashku me DBF/ZKF dhe drejtorinë e prokurimit përgatisin planin për rrjedhës së parasë.</p> <p>1.2. DBF/ZKF e dërgon planin e rrjedhës së parasë në MF.</p>	<p>1. Drejtorët e Drejtorive përkatëse</p> <p>2. DBF/ZKF</p> <p>3. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit</p>	Në fillim të vitit	1. Plani i rrjedhës së parasë	<p>1. Rregullore MF Nr. 03/2014 për Alokimin e Fondeve</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>
2.	Kërkesa për inicim të shpenzimit	<p>2.1. Për shpenzimet që kërkojnë procedura të prokurimit, zyrtari përgjegjës i njësisë kërkuese (drejtorisë përkatëse) përgatitë:</p> <p>2.1.1 Për mallra, punë dhe shërbime që janë të planifikuara në planin final të prokurimit, kërkesën me shkrim për mallra, punë dhe shërbime; dhe</p> <p>2.1.2 Nëse blerja nuk është e planifikuar në planin final të prokurimit, paraqitet arsyetimi për blerje.</p>	<p>1. Zyrtarët e departamenteve</p> <p>2. Drejtori i drejtorisë (mbajtësi i buxhetit)</p>	Nuk ka	<p>1. Kërkesa për mallra , punë dhe shërbime në kopje fizike</p> <p>2. Memo për trajnime, udhëtime, etj.</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rrregull financiare Nr. 01/2010/MF –</p>

		<p>2.2. Për shpenzimet që nuk kërkojnë procedura të prokurimit, zyrtari përgjegjës i njesisë kërkuese (drejtorisë) përgatitë:</p> <p>2.2.1 Kërkesën për shpenzime bazuar në nevojat dhe buxhetin e drejtorisë.</p> <p>2.3. Iniciuesi i kërkesës e dërgon atë tek drejtori i drejtorisë (mbajtësi i buxhetit).</p>				<p>Menaxhimi i Kontrollit Financiar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>3. Rregull financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>
3.	Vlerësimi i nevojave dhe aprovimi i kërkesës	<p>3.1. Pas pranimit të kërkesës për shpenzime, drejtori i drejtorisë psërkatëse (mbajtësi i buxhetit) kontrollon kërkesën lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> Natyrën dhe fushëveprimin e saktë të nevojave që mallrat/shërbimet e kërkuara synojnë të plotësojnë; Vlerën e parashikuar, si dhe kushtet materiale të kontratës publike që do t'i nënshtrohet prokurimit të parashikuar; Specifikat funksionale të secilit mall ose shërbim; Përfitimet e pritura; 	<p>1. Drejtori i drejtorisë.</p> <p>2. DBF/ZKF.</p>	Nuk ka	<p>1. Kërkesa për mallra, punë dhe shërbime në kopje fizike.</p> <p>2. DNPDP.</p> <p>3. Memo për trajnime, udhëtime, etj.</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi</p>

		<ul style="list-style-type: none"> Nëse prokurimi i synuar ka qenë i përfshirë në planifikimin e prokurimit, nëse jo, arsyet përse shpenzimi nuk është planifikuar; dhe Një deklaratë të qartë se si prokurimi do t'i promovojë objektivat institucionale. <p>3.2. Drejtori i plotëson pjesën II.1 të Deklaratës të Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve (DNPDP).</p> <p>3.3. Drejtori dërgon DNPDP e nënshkruar tek DBF/ZKF për kontrollim të disponueshmërisë së fondeve.</p>				Financiar dhe Kontrolli (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
4.	Kontrolli i disponueshmërisë së fondeve	<p>4.1. DBF/ZKF formalisht siguron që fondet janë ndarë për aktivitetin në fjalë dhe janë të mjaftueshme për kryerjen e obligimeve financiare gjatë vitit vijues fiskal.</p> <p>4.2. DBF/ZKF nënshkruan pjesën II.1 të DNPDP-së lidhur me disponueshmërinë e fondeve.</p> <div data-bbox="595 986 1167 1214" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px;"> <p style="text-align: center;">KUTIA 1</p> <p>Për kontratat më shumë se një vjeçare, DBF/ZKF duhet të përfshijë një dispozitë në kontratë e cila zbatimin e obligimeve të ardhshme e kushtëzon me disponueshmërinë e fondeve bazuar në ndarjet e ardhshme buxhetore.</p> </div> <p>4.3. DBF/ZKF e dërgon DNPDP tek Kryetari i Komunës për aprovim dhe nënshkrim.</p>	1. DBF/ZKF	Nuk ka, por para fillimit të shpenzimit	1. DNPDP e nënshkruar	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli</p>

						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 3. Doracaku i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit - Njësia Qendrore Harmonizuese-MF. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
5.	Aprovimi final i kërkesës për shpenzime dhe për inicim të shpenzimeve	5.1. Pas pranimit të kërkesës për blerje, kryetari i komunës vlerëson: <ul style="list-style-type: none"> • Nëse vlerësimi i nevojave arsyeton zhvillimin e aktivitetit të prokurimit të kërkuar; dhe • Për kërkesa të reja, nëse shpenzimi ndërlidhet me objektivat e drejtorisë dhe të komunës. 5.2. Nëse kërkesa aprovohet, ajo përcillet tek Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit 5.3. Nëse kërkesa nuk aprovohet, ajo kthehet tek drejtori i departamentit (shih aktivitetin 2).	1. Kryetari i komunës	Nuk ka	1. Kërkesa për blerje	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
Nën-procesi: Zotimi i Fondeve						

6.	Përgatitja e kërkesës për zotim dhe regjistrimi i zotimit të fondeve në SIMFK	<p>Për shpenzimet që kërkojnë prokurim:</p> <p>6.1. Pas aprovimit të kërkesës, zyrtari përgjegjës financiar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Verifikon nëse mjetet financiare janë në dispozicion në linjën e kërkuar buxhetore; • Plotëson të dhënat për Kërkesën e Zotimit për Blerje; • Regjistron kodet e klasifikimit të buxhetit (kodin e fondeve, organizativ, programit, funksionit dhe kodin ekonomik), sasinë; dhe <p>6.2. Zyrtari përgjegjës financiar i përcjell zyrtarit autorizues dokumentin Kërkesën e Zotimit për Blerje.</p> <p>6.3. Zyrtari zotues pas pranimit të dokumentit Kërkesën e Zotimit për Blerje regjistron:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat në SIMFK; • Kontrollon nëse ka fonde të mjaftueshme në linjën e kërkuar buxhetore dhe fondet e kërkuara ngrihen për obligimet e ardhshme; dhe • Përcaktohen datat e mundshme të pagesave; dhe • Nënshkruan dokumentin Kërkesë për Zotim për Blerje 	<p>1. DBF/ZKF.</p> <p>2. Zyrtari përgjegjës financiar.</p> <p>3. Zyrtari zotues.</p>	Tre ditë pas pranimit të dokumentacionit	<p>1. Kërkesa e zotimit për blerje (kopje fizike).</p> <p>2. Kërkesa për mallra dhe shërbime e (krijuar në SIMFK moduli i blerjeve dhe të nënshkruar nga zyrtari zotues).</p> <p>3. DNPDF pranuar nga DBF/ZKF.</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
----	---	---	--	--	--	--

		<p>6.4. Në rastet kur fondet për zotim nuk janë në dispozicion, zyrtari zotues duhet të informojë Drejtorin e Drejtorisë përkatëse përmes ZKF dhe ta kthej kërkesën.</p> <p>6.5. Nëse fondet zotohen, DNPDPF (në kopje fizike) dhe kërkesa për mallra dhe shërbime dërgohet tek zyra e prokurimit.</p>				
7.	Zotimi i fondeve për shpenzimet operative pa procedurë të prokurimit	<p>Për shpenzimet që nuk kërkojnë procedura të prokurimit</p> <p>7.1. Pas pranimit të faturës, zyrtari i përgjegjës për pranim të faturave i dërgon zyrtarit përgjegjës financiar të drejtorisë përkatëse për përgatitje të lëndës për zotim.</p> <p>7.2. Zyrtari zotues regjistron zotimet dhe obligimet në të njëjtën kohë dhe vetëm pas pranimit të lëndës së kompletuar (faturë, raportit të pranimit, dhe urdhër obligimi për pagesë).</p>	1. Zyrtari zotues.	Brenda tre ditëve pas pranimit të faturës nga DBF/ZKF	<p>1. Kërkesë për shpenzime.</p> <p>2. Fatura.</p> <p>3. Raporti i pranimit.</p> <p>4. Urdhër obligimi për pagesë (pjesa A) e krijuar në SIMFK - moduli i aprovimit.</p>	1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
8.	Procesi i prokurimit	<p>8.1. Njësia kërkuese plotëson DNPDPF dhe e dërgon tek DBF/ZKF dhe Kryetari i Komunës për aprovim.</p> <p>8.2. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit njoftohet nga AQP paraprakisht për të gjitha kontratat</p>	1. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	5 ditë para incimit të aktivitetit të prokurimit	1. DNPDPF	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

		<p>ekzistuese kornizë dhe të njëjtat u dërgohen të gjitha drejtorive dhe programeve në komunë.</p> <p>8.3. Nëse për blerjen e kërkuar ekziston një kontratë kornizë në AQP, njësia kërkuese e përdorë atë kontratë.</p> <p>8.4. Nëse aktiviteti i prokurimit nuk ka qenë i planifikuar, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit e dërgon DNPDP në AQP së paku 5 ditë para autorizimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.</p> <p>8.5. Nëse AQP nuk synon të zhvillojë procedurë të përbashkëta të prokurimit rreth blerjes në fjalë, autoriteti kontratkues vazhdon inicimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë.</p> <p>8.6. Zyrtari i prokurimit pas përgatitjes së dosjes së tenderit dorëzon DT tek Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit për aprovim</p> <p>8.7. Pas aprovimit nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, ZP zhvillon procedurat e prokurimit për prokurimin në fjalë.</p>	2. Njësia kërkuese			<p>Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>3. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
9.	Procesi i kontraktimit	9.1. Pas dhënies së kontratës dhe para nënshkrimit të kontratës, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, DBF/ZKF dhe Kryetari i Komunës ri-sigurojnë disponueshmërinë e	1. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	Kontrata nënshkruhet pas publikimit të	1. DNPDP	1.Ligji për Prokurimin

		<p>fondeve dhe se informatat financiare janë të njëjtat me DNPDF apo në rast se ka ndonjë ndryshim, atëherë konfirmohet nëse mund të sigurohen fondet (duke nënshkruar pjesën e III-të të DNPDF.</p> <p>9.2. Kontratat për shërbime dhe furnizime nën 125,000 EUR nënshkruhen prej Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit.</p> <p>9.3. Kontratat mbi 125,000 EUR nënshkruhen nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe Kryetari i Komunës.</p> <p>9.4. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dërgon kontratën e nënshkruar tek njësia kërkuuese, DBF/ZKF dhe menaxher i kontratës.</p>	2. Kryetari i Komunës	Njoftimit për Dhënie të Kontratës	2. Kontrata	Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
10.	Identifikimi/regjistrimi i furnitorit në Thesar	<p>10.1. Pas nënshkrimit të kontratës, ZKF ose zyrtari përgjegjës financiar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Verifikon identitetin e furnitorit; • Plotëson formularin e kërkuar; dhe • Dërgon të dhënat bankare të furnitorit në Thesar. <p>10.2. Nëse furnitori nuk është i regjistruar në SIMFK, ZKF kompletton dokumentet e kërkuara për regjistrimin e furnitorit dhe verifikon saktësinë e informatave të furnitorit (informatat verifikohen në ueb faqet e ATK-së dhe ARBK-së).</p>	1. DBF/ZKF	Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe para gjenerimit të urdhërbljes nga SIMFK	1. Formulari për regjistrim të furnitorit	1. Procedura për regjistrimin e Furnitorëve në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit)

		10.3. ZKF plotëson formularin e regjistrimit të furnitorit dhe e dorëzon në Thesar sipas procedurës për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK				
11.	Aktivitetet për menaxhimin e kontratës	<p>11.1. Pas nënshkrimit të kontratës, Kryetari i Komunës cakton menaxherin e kontratës (Më detajisht rreth menaxhimit të kontratave, shih procesin e menaxhimit të kontratave)</p> <p>11.2. DBF/ZKF njoftohet për emërimin e menaxherit të kontratës.</p> <p>11.3. Menaxheri i kontratës/projektit në në komunë në bashkëpunim me menaxherin e kontratës së operatorit ekonomik përgatisin dokumentin Plani i Menaxhimit të Kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Projektit dhe Operatorit Ekonomik.</p> <p>11.4. Menaxheri i Projektit/kontratës, brenda 2 ditëve të punës, do ta përcjell një kopje të planit për menaxhimin e kontratës departamentit të prokurimit.</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Menaxheri i Kontratës/Projektit</p> <p>3. DBF</p>	Pasi të nënshkruhet kontrata	<p>1. Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës (kopje fizike)</p> <p>2. Plani i menaxhimit të kontratës i nënshkruar nga menaxheri i kontratës dhe operatori ekonomik</p>	<p>1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
12.	Nënshkrimi i aneks-kontratës [OPSIONALE]	12.1. Menaxheri i kontratës së bashku me drejtorin e drejtorisë përkatëse, përgatisin raport të detajuar lidhur me nevojën për kontratë shtesë dhe e dërgon tek Kryetari i Komunës për aprovim.	<p>1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit</p> <p>2. Kryetari i Komunës</p>	Pas aprovimit të kërkesës për aneks kontratë	1. Aneks kontrata e nënshkruar	1. Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<p>12.2. Nëse kërkesa aprovohet, zyrtari përgjegjës i prokurimit harton aneks kontratën, pasi që të njofton KRPP-në.</p> <p>12.3. Aneks kontrata nënshkruhet nga Zyrtari përgjegjës dhe operatori ekonomik.</p>	3. Operatori ekonomik			2. Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).
13.	Krijimi i urdhërblërjes	<p>13.1. Pas nënshkrimit të kontratës/regjistrimit të të dhënave bankare të furnitorit në Thesar, menaxheri i kontratës i lëshon operatorit ekonomik letrën e njoftimit respektivisht fletë porosinë (urdhërblërjen).</p> <p>13.2. Menaxheri i kontratës siguron nënshkrimin e furnitorit në urdhërblërje për ri konfirmimin e afateve për kryerjen e shërbimeve apo ofrimin e mallrave.</p>	1. Menaxheri i kontratës	Brenda tri ditëve pas nënshkrimit të kontratës	1. Urdhërblërja nga SIMFK	<p>1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike</p>

						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 3. Procedura e Thesarit për rregullat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
Nën-procesi: Verifikimi i shpenzimeve						
14.	Pranimi i faturës	14.1. Fatura pranohet përmes protokollit të zyrës së financave respektivisht nga zyrtari përgjegjës për pranim të faturave.	1. Zyrtari përgjegjës për pranim të faturave	Nuk ka	1. Protokollimi i faturës.	Nuk ka
15.	Pranimi fizik i mallrave dhe shërbimeve	15.1. Menaxheri i kontratës monitoron implementimin e kontratës dhe pranimin final të mallrave dhe shërbimeve. 15.2. Pranimi i mallrave/shërbimeve bëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> • Zyrtari i pranimit të mallit për blerjet nën 1,000 EUR; dhe • Komisioni i pranimit për blerjet mbi 1,000 EUR (komisioni caktohet nga 	1. Zyrtari i Pranimit për Blerjet nën 1,000 EUR 2. Komisioni për pranim fizik të mallrave	Nuk ka	1. Procesverbali i komisionit (në letër) 2. Raporti i pranimit	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<p>kryetari bazuar në propozimin e drejtorit të drejtorisë përkatëse).</p> <p>15.3. Komisioni i pranimi të mallrave/shërbimeve kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nëse sasia, cilësia dhe karakteristikat e mallit/shërbimeve të pranuar janë në përputhje me kontratën (specifikat teknike); • krahason nëse fletëdërgesa e mallit përputhet me urdhërblenjen; dhe • nëse mallrat/shërbimet nuk përputhen me kontratën dhe urdhërblenjen, komisioni për pranim të mallrave i kthen ato tek operatori ekonomik apo jep vërejtjet e tij për korrigjim <p>15.4. Komisioni i pranimi pas pranimi të mallrave/shërbimeve përpilon një raport të pranimi që nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.</p> <p>15.5. Raporti i pranimi të mallrave/shërbimeve nga komisioni i pranimi dërgohet tek zyra për buxhet dhe financa (së bashku me kontratën, urdhër blenjen, faturën etj.)</p>				<p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>3. Procedura e Thesarit për rregullat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>4. Procedura e Ministrisë së</p>
--	--	--	--	--	--	---

						<p>Financave Nr. 2 - Delegimi i Përgjegjëse (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>4. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 5 - Menaxhimi i Pasurive (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>5. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 11 - Kapitali (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p>
--	--	--	--	--	--	---

16.	Regjistrimi i pranimit të mallrave/shërbimeve në SIMFK	<p>16.1. Zyrtari përgjegjës për pranimin e mallrave në SIMFK regjistron pranimin e mallrave në SIMFK.</p> <p>16.2. Zyrtari për pranimin e mallrave dërgon raportin e pranimit të mallit nga SIMFK dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës të zyrtari i shpenzimeve.</p>	1. Zyrtari për pranimit të mallit në SIMFK	Nuk ka	1. Raporti i pranimit të mallit nga SIMFK	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>3. Procedura e Thesarit për rregullat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p>
17.	Çertifikimi (kontrollimi) i dokumentacionit për pagesë nga Zyrtari Çertifikues	<p>17.1. Para se të regjistrohet shpenzimi në SIMFK, Zyrtari çertifikues çertifikon dokumentacionin për pagesë 14 si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesën për shpenzime; • DNPDP; • Zotimin e fondeve në SIMFK; • Urdhërblertjen në SIMFK; dhe 	1. Zyrtari certifikues	Pas regjistrimit të pranimit të punëve në SIMFK	Nuk ka	1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<ul style="list-style-type: none"> • Procesverbalin dhe raportin e pranimit të komisionit të pranimit teknik. <p>17.2. Nëse kushtet e kërkuara për certifikim nuk plotësohen, atëherë zyrtari certifikues nuk do ta certifikojë dokumentacion për pagesë, e kthen lëndën mbrapa dhe njofton Kryetarin e Komunës.</p> <p>17.3. Nëse kushtet e kërkuara për certifikim plotësohen, atëherë zyrtari certifikues dërgon lëndën tek zyrtari shpenzues për regjistrim të shpenzimit.</p>				
18.	Regjistrimi i shpenzimit në SIMFK	<p>18.1. Zyrtari shpenzues pas pranimit të dokumentacionit verifikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zotimin e fondeve në SIMFK; • Nënshkrimet e autorizuara; • Kodet ekonomike të shpenzimit; dhe • Përfituesin dhe llogarinë bankare. <p>18.2. Zyrtari shpenzues bën regjistrimin e shpenzimit në SIMFK dhe gjeneron Urdhrin për Pagesë.</p> <p>18.3. Zyrtari i shpenzimeve përcjell dokumentacionin e plotë financiar të zyrtari certifikues për aprovim të shpenzimeve në SIMFK.</p>	1. Zyrtari i shpenzimeve	Brenda tri ditëve nga pranimi i dokumenteve e në zyre	1. Dokumenti Urdhëri për Pagesë nga SIMFK	NA
Nën-procesi: Lirimi i fondeve të pa përdorura						

19.	Lirimi i fondeve të pa përdorura	<p>19.1. Zyrtari shpenzues kontrollon vlerën totale të faturave kundrejt fondeve të zotuarra dhe përgatitë një kërkesë për Thesarin në MF për lirim të fondeve të lira nga zotimi përkatës.</p> <p>19.2. Kërkesa për lirim të fondeve duhet paraprakisht të aprovohet nga personat përgjegjës në komunë.</p> <p>19.3. Kërkesa e aprovuar dërgohet në Thesar.</p>	<p>1. Zyrtari i shpenzimeve</p> <p>2. DBF / ZKF</p> <p>3. Kryetari i Komunës</p>	Nuk ka	1. Kërkesa për lirim të fondeve të pa përdorura (kopje fizike).	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
20.	Kontrolli i pajtueshmërisë	<p>20.1. Pas pranimit të dokumentacionit financiar, zyrtari certifikues kontrollon dokumentet fizike si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesën për shpenzime; • DNPDPF; • Zotimin e fondeve në SIMFK; • Urdhër blerjen në SIMFK; dhe • Procesverbalin dhe raportin e pranimit të komisionit të pranimit të mallrave. <p>20.2. Nëse zyrtari certifikues nuk e certifikon lëndën për pagesë si rezultat i mungesës së ndonjë dokumenti apo parregullësie, lëndën e kthen mrapa dhe njofton Kryetarin e Komunës.</p>	1. Zyrtari certifikues	Nuk ka	Nuk ka	<p>1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare</p>

						e Republikës së Kosovës). 3. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
21.	Hetimi në rast të parregullsive (OPSIONALE)	21.1. Në rast se shpenzimi nuk është certifikuar për shkak të dyshimit për ndonjë pa rregullsi, Kryetari i Komunës krijon komision të rastit për hetimin e procedurave. Procesi i pagesës bllokohet deri në vendimin final të komisionit.	1. Kryetar i Komunës	Nuk ka	1. Raport nga komisioni hetues	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
22.	Regjistrimi i pasurive të blera	22.1. Zyrtari i pasurive pranon nga zyrtari i depos dokumentin për pasuritë e blera. 22.2. Regjistron inventarin dhe të gjitha pasuritë fizike në regjistrin e pasurive. 22.3. Ruan shënimet rreth vendndodhjes dhe personave të ngarkuar për çdo pasuri.	1. Zyrtari i pasurisë 2. Zyrtari i depos	Nuk ka	1. Dokumenti i krijuar nga programi e-pasuria 2. Krijohen barkodet nga e-pasuria të cilat	1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore

					<p>vendosen në të gjitha pajisjet</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Procedura e Thesarit për rregullat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>3. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 2 - Delegimi i Përgjegjësive (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>4. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 5 - Menaxhimi i Pasurive</p>
--	--	--	--	--	---

						(Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
Nën-procesi: Aprovimi dhe pagesat						
23.	Aprovimi i pagesës	23.1. Pas kontrollit të dokumentacionit financiar, zyrtari certifikues aprovon lëndën për pagesë.	1. Zyrtari certifikues	NA	1. Aprovimi në SIMFK	<p>1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

						<p>3. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>4. Procedura e Ministrisë së Financave për të drejtat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p>
24.	Kryerja e pagesës	24.1. Divizioni i pagesave në Thesar kontrollon likuiditetin në Llogarinë e Vetme të Thesarit (LLVTh) dhe realizon pagesat nga LLVTh.	1. Thesari.	Brenda tri ditëve pas aprovimit të pagesës	1. Pagesa elektronike nga Thesari.	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

						2. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
Nën-procesi: Barazimi						
25.	Barazimi i të dhënave me LLVTH	<p>25.1. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) gjeneron pasqyrën bankare elektronike dhe një raport të pagesave të gabuara.</p> <p>25.2. Thesari komunikon me DBF/ZKF të komunës për pagesat e gabuara dhe i korrigjon dosjet më së largu të nesërmen.</p>	<p>1. Thesari</p> <p>2. BQK</p>	Brenda ditës së nesërme	1. Komunikimi me e-mail me DBF/ZKF	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p>

26.	Raportimi i pagesave ditore	26.1. Zyrtari përgjegjës i kontabilitetit: <ul style="list-style-type: none"> • krijon raporte për të pagueshmet dhe të arkëtueshmet, pagesat; dhe • krijon një bazë të të dhënave për pagesat e kryera. 	1. Zyrtari i shpenzimeve	Pagesat bëhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturës	1. Raportet ditore për llogaritë e pagueshme 2. Pagesat në SIMFK 3. Databazat në Excel	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
Fundi i procesit të shpenzimeve publike për Mallra dhe Shërbime						

3. PROCESI I SHPENZIMEVE - MALLRA DHE SHËRBIME: LISTA E RREZIQEVE

3.1 Vonesa në furnizim të mallrave dhe shërbimeve

3.2 Furnizim me mallra dhe shërbimeve të cilësisë jo të duhur dhe jo sipas kushteve të kontratës

3.3 Vonesa në pagesat e faturave

3.4 Krijimi i obligimeve në mungesë të zotimit të fondeve të mjaftueshme

	Numri i Referencës	3.1
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Operacional
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	<i>Furnizimi me mallra dhe shërbime në kohë të duhur, brenda buxhetit dhe të cilësisë adekuate për të përmbushur caqet operative të komunës</i>
	Ngjarja e rrezikut	Vonesa në furnizim të mallrave dhe shërbimeve
	Shkaku i Rrezikut	Porositja e mallrave dhe shërbimeve me vonesë Afati i caktuar për liferim të mallrave ose shërbimeve jo real Mosmarrëveshje eventuale ndërmjet operatorëve ekonomik dhe komunës
	Ndikimi/Pasoja	Dështimi për të kryer aktivitetet operative të komunës apo çrregullimi i aktiviteteve të rregullta Dështimi për të ofruar shërbime komunale dhe realizuar objektivat prioritare të komunës Shkelja e obligimeve kontraktuale dhe nevoja për të zbatuar ndëshkimet e përcaktuara me kontratë
	Masat ekzistuese të kontrollit	Dënimet në rast të vonesave

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Planifikimi i datave të liferimit
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Caktimi një afati real të liferimit të mallrave dhe shërbimeve Zbatimi i ndëshkimeve në rast të vonesave të pa arsyeshme
	Forma e masave	Zbatimi i ndëshkimeve
	Burimet që kërkohen	Angazhimi i stafit
	Pronari i rrezikut	Menaxheri i kontratës
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	Operatorët ekonomik
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët
Numri i Referencës	3.2	

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Operacional, Pajtueshmëri
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	<i>Furnizimi me mallra dhe shërbime në kohë të duhur, brenda buxhetit dhe të cilësisë adekuate për të përmbushur caqet operative të komunës</i>
	Ngjarja e rrezikut	Furnizim me mallra dhe shërbimeve të cilësisë jo të duhur dhe jo sipas kushteve të kontratës
	Shkaku i Rrezikut	Specifikat teknike jo të qarta në dosje të tenderit Përzgjedhja e operatorit ekonomik apo të mallrave jo adekuate Kontrolle të dobëta gjatë pranimit të mallrave ose shërbimeve
	Ndikimi/Pasoja	Dështimi për të kryer aktivitetet operative të komunës apo çrregullimi i aktiviteteve të rregullta Dështimi për të ofruar shërbime komunale dhe realizuar objektivat prioritare të komunës Vonesa në implementim të kontratës, anulim të mundshëm të kontratës, apo nevoja për përsëritje të procedurave të prokurimit Rritja e kostos për komunën dhe shpenzime jo efikase
	Masat ekzistuese të kontrollit	Vendosja e specifikave teknike dhe standardeve Komisionet e pranimit të mallrave ose shërbimeve
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	4
	Rezultati	12
	Prioriteti i rrezikut	Lartë

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të mjaftueshme
	Veprimi	Trajtimi dhe zvogëlimi
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Specifikimi i qartë i natyrës së blerjes, llojit dhe cilësisë së mallrave ose shërbimeve Përcaktimi i kriterëve të qarta të vlerësimit të ofertave dhe përzgjedhja e operatorit sipas tyre Forcimi i kontrolleve në menaxhimin e kontratave dhe gjatë pranimit të mallrave ose shërbimeve
	Forma e masave	Planifikim, raportim
	Burimet që kërkohen	Angazhimi i stafit
	Pronari i rrezikut	Menaxheri i kontratës
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	Operatorët ekonomik
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

	Numri i Referencës	3.3
I D E	Kategoria	Operacional, Pajtueshmëri

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Nën procesi	N/A
	Objektivi	<i>Furnizimi me mallra dhe shërbime në kohë të duhur, brenda buxhetit dhe të cilësisë adekuate për të përmbushur caqet operative të komunës</i>
	Ngjarja e rrezikut	Vonesa në pagesat e faturave
	Shkaku i Rrezikut	Mungesa e buxhetit Mallrat ose shërbimet e ofruara nuk janë sipas kontratës Neglizhenca ose veprimet e qëllimshme Dërgimi i faturave nga drejtoritë përkatëse tek zyra e financave me vonesë Mungesa e dokumenteve mbështetëse për kryerjen e pagesave
	Ndikimi/Pasoja	Krijimi i obligimeve të pa paguara Ankesat e furnitorëve, përbarimi i lëndëve përmes përbaruesve ose paditë në gjykatë Humbje financiare për komunën
	Masat ekzistuese të kontrollit	Ndëshkimet nga operatori ekonomik Raportimi i obligimeve të pa paguara
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	5
	Pasoja (1-5)	2
	Rezultati	10
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Pagesa e faturave brenda afatit ligjor (30 ditë) nga data e pranimit të faturave Të gjitha faturat e pranuar nga drejtoritë duhet të përcjellën në zyrën e financave menjëherë pas pranimit të tyre Përgatitja e raporteve mujore për faturat e vonuara dhe arsyet për mos pagesën e tyre me kohë Analiza e arsyeve për vonesa në pagesën e faturave me kohë
	Forma e masave	Raport për faturat e pa paguara
	Burimet që kërkohen	Angazhim i stafit
	Pronari i rrezikut	Menaxheri i kontratës
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	Operatorët ekonomik
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


	Numri i Referencës	3.4
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Financiar
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	<i>Furnizimi me mallra dhe shërbime në kohë të duhur, brenda buxhetit dhe të cilësisë adekuate për të përmbushur caqet operative të komunës</i>
	Ngjarja e rrezikut	Krijimi i obligimeve në mungesë të zotimit të fondeve të mjaftueshme
	Shkaku i Rrezikut	Planifikim i dobët i rrjedhjes së parasë Nënvlerësimi i kostove të blerjeve Planifikim jo i sakët i buxhetit
	Ndikimi/Pasoja	Mungesa e mjeteve për pagesa të mallrave ose shërbimeve Rritja e obligimeve të pa paguara Paditë e mundshme gjyqësore dhe procedura të tej zgjatura
	Masat ekzistuese të kontrollit	Proceset e zotimit për shpenzim të parasë publike
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	2
	Pasoja (1-5)	2
	Rezultati	4
	Prioriteti i rrezikut	Ulët
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme


Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


	Veprimi	Monitorimi dhe trajtimi
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përmirësim i procesit të planifikimit të shpenzimeve dhe rrjedhjes së parasë Aprovimi i inicimit të blerjeve vetëm pasi të jetë siguruar disponueshmëria e mjeteve të mjaftueshme
	Forma e masave	Plan veprimi
	Burimet që kërkohen	Burime njerëzore
	Pronari i rrezikut	DBF / ZKF
	Data e përfundimit	TM4 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MF
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët


Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 – Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


4. PROCESI I SHPENZIMEVE: MALLRA DHE SHËRBIME: DIAGRAMI I PROCESIT











V. PROCESI I SHPENZIMEVE - AVANCE DHE PARAJA E IMËT

1. PROCESI I SHPENZIMEVE – AVANCET DHE PARAJA E IMËT: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i Menaxhimit të shpenzimeve për avancet për para të imëta (Petty Cash)
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<DATA>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të menaxhimit avanteve për para të imëta (petty cash). Ky proces përcakton limitin e caktuar nga Thesari i Ministrisë së Financave dhe procedurat për rimbushje të avancit për para të imëta.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
Versioni:	V. 01/2018
Korniza ligjore:	1. Rregullore e MF – Nr. 01/2013, Shpenzimi i parasë publike. 2. Rregullore e MF – Nr. 02/2014 për përfundimin e vitit fiskal. 3. Procedura e avanteve për paranë e imët (petty cash) dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK.
Pronari i Procesit:	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
Palët e përfshira në proces:	1. Kryetari i Komunës 2. Drejtorët e Drejtorive Përkatëse 3. Drejtori për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesore Financiar 4. Zyrtari i Zotimit 5. Njësia për Kredit Kartela dhe Transfere – Thesari i MF 6. Mbajtësi i autorizuar i parasë së imët 7. Pranuesi i parasë së imët nga drejtoria përkatëse 8. Zyrtari i Shpenzimeve 9. Zyrtari Certifikues 10. Thesari i MF
Sistemet e TI të përfshira në proces:	1. E-Mail 2. Inboxi i SIMFK
Dokumentet e përfshira në proces:	1. Deklarata për mbajtjen e parës së imët 2. Urdhër Obligimi për Pagesë 3. Formulari i zotimit të parasë së imët 4. Dëshmia e tërheqjes së parasë së imët nga banka komerciale 5. Fletëpranimi standard i parasë së imët/ fondi operativ 6. Formulari Specifikimi i Parasë së Imët 7. Kërkesa elektronike për rimbushje të avancit për para të imëta 8. Formulari për mbyllje të zotimit për avanc për para të imëta
Ndërlidhja:	NA
Numri i hapave:	11

2. PROCESI I SHPENZIMEVE – AVANCET DHE PARAJA E IMËT: PROCESI NË DETAJ

Procesi i shpenzimeve për avancet për para të imët (Petty cash)						
Hapat	Aktivitetet	Aktivitetet e kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet e gjeneruara	Korniza ligjore
1.	Autorizimi i personit përgjegjës për para të imëta (petty cash) dhe caktimi i shumës për avanc për para të imëta.	<p>1.1. Në fillim të vitit Kryetari i Komunës cakton personin përgjegjës për mbajtje të parasë së imët (petty cash).</p> <p>1.2. Kryetari i Komunës bën analizën për nevojën e shumës së parasë së imët për programet/nën-programin dhe vendos për shumën.</p> <p>1.3. Personi përgjegjës plotëson Deklaratën për Mbajtjen e Parasë së Imët, duke përfshirë shumën e vendosur në pikën 1.2, dhe e nënshkruan Deklaratën.</p> <p>1.4. DBF/ZKF e rishikon Deklaratën e plotësuar, e aprovon dhe e nënshkruan deklaratën.</p> <p>1.5. Deklarata e plotësuar dërgohet tek Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit (DPTTh) për aprovim.</p>	<p>1. Personi përgjegjës i caktuar nga Kryetari i Komunës</p> <p>2. ZKF</p>	Nuk ka	1. Deklarata për Mbajtjen e Parasë së Imët (Petty cash)	1. Procedura e avanceve për parane të imët (petty cash) dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK (Ministria e Financave).
2.	Hapja e nën-llogarisë bankare për para të imëta për komunën përkatëse	2.1 DPTTh njofton bankën komerciale për hapje të nën-llogarisë së komunës për para të imët (Petty cash).	1. DPTTh	Pas aprovimit	1. Njoftimi i bankës komerciale	1. Procedura e avanceve për parane të imët (petty cash) dhe

	në bankën komerciale	2.2 Në bazë të Deklaratës për Mbajtjen e Parasë së Imët, DPTTh dërgon informatat e personit të autorizuar tek banka komerciale për të lejuar tërheqjen e parasë së gatshme nga nën-llogaria.				udhëtimeve zyrtare në SIMFK (Ministria e Financave) .
3.	Zotimi i fondeve dhe transferi i parave për para të imëta (Petty cash)	3.1. Bazuar në shumën e autorizuar në nga DPTTh, Zyrtari i Autorizues (mbajtësi i buxhetit) plotëson Urdhër Obligimin për Pagesë (UOP), ku përfshin kodet ekonomike dhe shumat përkatëse për shpenzimin e parasë së imët (Petty cash). 3.2. Pas plotësimit të UOP, bëhet zotimi i mjeteve në SIMFK. 3.3. Mbajtësi i autorizuar i parasë së imët bën kërkesën e hapjes së avancit të parasë së imët (petty cash) të Thesarit të Ministrisë së Financave nëpërmjet Inboxit të SIMFK. 3.4. Zyrtari i zotimit e mban UOP deri në momentin e mbylljes së avancit dhe arsytimit të mjeteve.	1. Mbajtësi i Buxhetit 2. Zyrtari Zotues	Deri në mbylljen e avancit	1. Urdhër Obligimi për Pagesë 2. Formulari i zotimit të parasë së imët (Petty cash) në SIMFK	1. Rregullore e MF – Nr. 01/2013, Shpenzimi i parasë publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2. Procedura e avanceve për parane e imët (petty cash) dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK (Ministria e Financave) .
4.	Transferi i fondeve nga Llogaria e Vetme e Thesarit	4.1. Njësia për Kredit Kartela dhe Transfere bën transferimin e parave nga LLVTh në nën-	1. Njësia për Kredit Kartela	Nuk ka	1. Njoftimi përmes postës elektronike –	1. Procedura e avanceve për parane e imët

	(LLVTh) në BQK në nën-llogarinë e komunës në bankën komerciale	llogarinë bankare komerciale për komunën përkatëse. 4.2. Komuna njoftohet përmes Inboxit të SIMFK për transferin e parave në nën-llogarinë bankare komerciale.	dhe Transfere – Thesari		Inbox të SIMFK për transferin e fondeve 2. Regjistrimi i transferit të fondeve në Kupon Shpenzimit	(petty cash) dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK (Ministria e Financave).
5.	Tërheqja e parasë së imët nga nën-llogaria në bankën komerciale	5.1. Pas njoftimit për kompletimin e transferit, zyrtari i autorizuar i parasë së imët bën tërheqjen e shumës së nevojshme nga banka komerciale. 5.2. Në bazë të të dhënave të transaksioneve, Thesari bën regjistrimin e tërheqjes së parasë së imët në Kuponin e Shpenzimit (SIMFK).	1. Mbajtësi i autorizuar i parasë së imët 2. Thesari	Pas transferit nga Thesari në pikën 4.1	1. Dëshmia e tërheqjes së parasë së imët nga banka komerciale 2. Kuponin e Shpenzimit	

		<p>5.3. Mbajtësi i autorizuar i parasë së imët bën ruajtjen dhe shpenzimin e parasë së imët sipas dispozitave ligjore.</p> <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; text-align: center;"> <p>KUTIA 1</p> <p>Flete tërheqja e parasë së gatshme nga banka ruhet nga ZKF në fajllin e parasë së imët</p> </div>				
6.	Pranim/Dorëzimi parasë së imët (petty cash) nga Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët tek pranuesi në drejtorinë përkatëse në Komunë	<p>6.1. Në rast se pranimi i parasë së imët (petty cash) bëhet nga një zyrtari i caktuar nga Mbajtësi i autorizuar i parasë së imët, (sipas pikës 1.1) atëherë:</p> <p>6.1.1 Bazuar në nevojën e programeve/nën-programeve përkatëse, pranuesi i parasë së imët plotëson Fletëpranimin <i>Standard të Parasë së Imët / Fondi Operativ</i>, ku përcaktohet shuma për pagesë, specifikimi i shërbimeve, materialeve dhe pajisjeve për të cilat mjetet do të shpenzohen, etj.</p> <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; text-align: center;"> <p>KUTIA 2</p> <p>Në vend të drejtorisë përkatëse vendos program/nën-program.</p> </div>	<p>1. Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët</p> <p>2. Pranuesi në program/nën-program përkatëse (nëse ka)</p>	Nuk aplikohet	<p>1. Fletëpranimi Standard i Parasë së Imët / Fondi Operativ</p> <p>2. Formulari Specifikimi i Parasë së Imët</p>	<p>1. Procedura e avanceve për parane e imët (petty cash) dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK (Ministria e Financave).</p>

		<p>6.1.2 Mbajtësi i Parasë së Imët dorëzon paranë e imët sipas kërkesës të pranuesi i parasë së imët.</p> <p>6.1.3 Mbajtësi i Parasë së Imët pranon Fletëpranimin Standard të Parasë së Imët /Fondi Operativ nga pranuesi i parasë së imët dhe e nënshkruan fletëpranimin.</p> <p>6.1.4 Pranuesi i parasë së imët ruan faturat dhe/ose kuponët fiskal e rregullta burimore për shpenzimin e parasë së imët të pranuar.</p> <p>6.1.5 Pranuesi i parasë së imët bën dorëzimin e faturave dhe/ose kuponëve fiskal të rregullta burimore tek Mbajtësi i Parasë së Imët.</p> <p>6.1.6 Mbajtësi i Parasë së Imët përgatitë formularin e Specifikimit të Parasë së Imët sipas të dhënave të shpenzimit të pranuar nga pranuesi i parasë së imët nga drejtoria përkatëse (pika 6.1.5.)</p>				
7.	Shpenzimi i parasë së imët	<p>7.1. Zyrtari shpenzues pranon nga Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët evidencën ditore për pagesat nga fondi i parasë së imët (Petty Cash) me formularët:</p> <ul style="list-style-type: none"> Fletëpranimi Standard i Parasë së Imët / Fondi Operativ; dhe 	<p>1. Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët</p> <p>2. Zyrtari i Shpenzimeve</p>	Nuk aplikohet	<p>1.Fletëpranimi Standard i Parasë së Imët/Fondi Operativ</p> <p>2. Specifikimi i Parasë së Imët</p>	<p>1. Procedura e avanceve për paranë e imët (petty cash) dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK (Ministria e Financave).</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • Specifikimi i Parasë së Imët. <div data-bbox="613 240 1079 496" style="background-color: #4F81BD; color: white; padding: 10px; text-align: center;"> <p>KUTIA 3</p> <p>Regjistrimi i shpenzimeve të parasë së imët bëhet pa zotimin e mjeteve, sepse për zotimi bëhet paraprakisht.</p> </div> <p>7.2. Zyrtari i Shpenzimeve bën regjistrimin e Kuponit të Shpenzimit për shpenzimin e avancit për paranë e imët (Petty cash) në SIMFK.</p>			3. Kuponit i Shpenzimit në SIMFK	2. Rregullore e MF – Nr. 01/2013, Shpenzimi i parasë publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
8.	Çertifikimi i Shpenzimit	8.1. Zyrtari Çertifikues çertifikon shpenzimin e parasë së imët pas regjistrimit të Kuponit të Shpenzimit nga zyrtari i shpenzimeve.	1. Zyrtari Çertifikues 2. Zyrtari i Shpenzimeve	Nuk ka	1. Faqja e parë e pagesës nënshkruar nga certifikuesi	1.Rregullorja 01/2013, Shpenzimi i parasë publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

9.	Rimbushja e avancit të Parasë së Imët	<p>9.1. Për të rimbushur avancin për paranë e imët, shuma e plotë e avancit paraprak të parasë së imët duhet të regjistrohet si e shpenzuar në SIMFK.</p> <div data-bbox="629 363 1093 620" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; text-align: center;"> <p>KUTIA 4</p> <p>Rimbushja e avancit nuk lejohet të bëhet nëse avanci paraprak nuk është arsyetuar sipas legjislacionit në aplikueshëm.</p> </div> <p>9.2. Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët bën kërkesë tek Thesari për rimbushje të llogarisë të parasë së imët nëpërmjet Inboxit të SIMFK.</p> <ul style="list-style-type: none"> Kërkesa mund të bëhet vetëm për shuma dhe specifikat e shpenzimeve të bëra; dhe Në Inbox të SIMFK duhet të përfshihen numrat përkatës të transaksioneve (numrave të kuponëve të shpenzimit) që janë regjistruar në SIMFK. 	<p>1. Zyrtari i Shpenzimeve</p> <p>2. Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët</p>	Pas shpenzimit të parasë së imët dhe regjistrimit në sistem	1. Kërkesa elektronike për rimbushje të avancit për para të imët	1. Procedura e avanceve për paranë e imët (petty cash) dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK (Ministria e Financave).
10.	Mbyllja e avancit për para të imëta (petty cash)	10.1. Për zotimin e hapur për para të imët (Petty cash), Zyrtari i Shpenzimeve, bazuar në udhëzimet për mbylljen e vitit, bën mbylljen e avancit për para të imëta duke ndjekur këto hapa:	<p>1. Zyrtari i Shpenzimeve</p> <p>2. Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët</p>	Deri me 26 dhjetor në fund të vitit fiskal	1. Formularët për mbyllje të zotimit për avanc për para të imët (petty cash)	1. Rregullore MF – Nr. 02/2014 për përfundimin e vitit fiskal (Gazeta Zyrtare

		<p>10.1.1 Zyrtari i Shpenzimeve pranon nga Mbajtësi i Autorizuar i Parasë së Imët të gjitha faturat për shpenzimet e parasë së imët, kërkesat zyrtare për para të imët, UOP-të, fletëpranimet standard të parasë së imët, specifikimet e parave të imta, etj.</p> <p>10.1.2 Zyrtari i Shpenzimeve bën regjistrimin e shpenzimeve përfundimtare.</p> <p>10.1.3 Zyrtari i Shpenzimeve bën një regjistrim shtesë për të mbyllur zotimin e parasë së imët në fund të vitit sipas procedurave të SIMFK dhe udhëzimeve administrative për mbyllje të zotimit në fund të vitit.</p>				e Republikës së Kosovës)
7.	Pranimi i qarkores së parë nga Ministria e Financave	<p>7.1. Qarkorja e Ministrisë së Financave pranohet nga zyra e Kryetarit të Komunës (protokolli). Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb faqen zyrtare të MF.</p> <p>7.2. Kryetari i Komunës e dërgon qarkoren tek Drejtori për Buxhet dhe</p>	<p>1. Zyra e Kryetarit</p> <p>2. DBF/ZKF</p>	Deri me 15 Maj	<p>1. Qarkorja në format Word</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

		<p>Financa (DBF) / Zyrtaari Kryesor Financiar (ZKF).</p> <p>7.3. DBF/ZKF përcjell qarkoren tek drejtorët e të gjitha drejtorive përmes e-mailit dhe/ose kopje fizike.</p>				<p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
8.	Hartimi i qarkores së brendshme komunale	<p>8.1. Kryetari i Komunës e dërgon qarkoren tek Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF) / Zyrtaari Kryesor Financiar (ZKF).</p> <div data-bbox="618 711 1088 895" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px;"> <p style="text-align: center; margin: 0;">KUTIA 1</p> <p style="margin: 0;">Qarkorja e brendshme përcakton, qëllimet, objektivat, afatet dhe kërkesat nga drejtorët e drejtorive për shpenzimet për 3 vitet e ardhshme</p> </div> <p>8.2. DBF/ZKF siguron se zhvillimin e qarkores së brendshme të komunës (në nivel të programeve).</p> <p>8.3. Qarkoren e brendshme e përgatitë (vendosja e të dhënave në tabela të buxhetit) DBF/ZKF. Kjo bëhet bazuar në informatat financiare nga vitet paraprake.</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Zyrtaari Financiar për Arsim</p> <p>3. Zyrtaari Financiar për Shëndetësi</p>	15-22 Maj	1. Qarkorja e Brendshme Komunale në format Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
9.	Hartimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB)	<p>9.1. Bazuar në propozimet buxhetore të drejtorive dhe programeve si dhe inputet nga dëgjimet publike (brenda</p>	1. Kryetari i Komunës	10 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e

		kufijve buxhetor), Kryetari i Komunës në bashkëpunim me DBF/ZKF, dhe drejtorët e drejtorive hartojnë draft Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).	2. Drejtorët e drejtorive 3. DBF/ZKF			Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
10.	Prezantimi i draft KAB në dy komitete (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete)	10.1. Kryetari i komunës e aprovon draft KAB-it. 10.2. Pas aprovimit, Kryetari së bashku me DBF/ZKF prezanton draft KAB në: <ul style="list-style-type: none"> • Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF); dhe • Komitetin për Komunitete (KPK). 	1. Kryetari i Komunës 2. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) 3. Komiteti për Komunitete (KPK)	10-25 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

11.	KAB në Kuvend Komunal	<p>11.1. Draft KAB dërgohet në Kuvend Komunal për shqyrtim dhe aprovim.</p> <p>11.2. KAB aprovohet nga Kuvendi Komunal dhe vendimi për aprovim të KAB-it nënshkruhet nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal.</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Kuvendi Komunal</p> <p>3. Kryesuesi i Kuvendit Komunal</p>	Deri më 30 Qershor	1. Vendimi i për aprovim të Kornizës Afatmesme të Buxhetit	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
12.	Dorëzimi i KAB në MF	12.1. Kryetari i Komunës e dërgon KAB (të aprovuar nga Kuvendi Komunal) në MF.	1. DBF/ZKF	30 Qershor	1. KAB-i aprovuar	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e</p>

						Republikës së Kosovës).
13.	Dëgjimet publike	13.1. Mbahen dëgjime publike me qytetarë me qëllim të diskutimit të Projekt Propozimit të Buxhetit. Organizohen së paku 3 dëgjime publike.	1. Kryesuesi i Kuvendit 2. DBF/ZKF	Gusht	1. Projekt Propozimi i Buxhetit	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
14.	Pranimi i qarkores së dytë nga Ministria e Financave (opsionale)	14.1. Dokumenti i Ministrisë së Financave pranohet në formë elektronike (e-mail) nga protokolli i Kryetarit të Komunës. Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb site të MF. <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px; text-align: center;">KUTIA 2 Përderisa Qarkorja e parë përcakton kufijtë buxhetor, qarkorja e dytë specifikon se ku do të shpenzohet buxheti. Ministria e Financave mund të lëshojë më shumë se 1 qarkore</div>	1. Kryetari i komunës	1 Korrik	Qarkorja e dytë buxhetore në Word	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal

						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
15.	Hartimi i qarkores së dytë të brendshme të Komunës dhe shpërndarja e saj tek drejtorët e drejtorive	<p>15.1. Hartohet qarkorja e dytë e brendshme e komunës nga DBF/ZKF (përfshihen inputet nga diskutimet e brendshme nga drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e programeve).</p> <p>15.2. DBF/ZKF dërgojnë qarkoren e dytë të brendshme tek drejtorët dhe udhëheqësit e njësive për plotësim. Qarkorja përcakton kufijtë buxhetor për kategori ekonomike.</p>	2. DBF/ZKF	Fundi i Korrikut	1. Qarkorja e Dytë Buxhetore	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
16.	Përgatitja e projekt buxhetit dhe kërkesave për ndarje buxhetore në nivel të drejtorive	<p>16.1. Pas pranimit dhe shpërndarjes së qarkores së dytë të brendshme, drejtorët e drejtorive organizojnë diskutime brenda drejtorive për të diskutuar kërkesat buxhetore.</p> <p>16.2. Drejtorët e drejtorive i dërgojnë kërkesat buxhetore tek DBF/ZKF.</p>	<p>1. DBF/ZKF</p> <p>2. Drejtorët e drejtorive</p>		Propozimet buxhetore (PCF1,2,3 dhe 4)	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e</p>

						Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
17.	Prezantimi në Kuvendin Komunal	17.1. Pas shqyrtimit të buxhetit në KPF, projekt buxheti prezantohet dhe diskutohet në Kuvendin Komunal.	1. Kryetari i Komunës	Deri 30 Shtator	1. Projekt buxheti	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
18.	Aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunal	18.1. Buxheti aprovohet nga Kuvendi Komunal.	1. Kuvendi Komunal	Deri me 30 Shtator	1. Buxheti i aprovuar 2. Vendim i Kuvendit Komunal për buxhetin e aprovuar	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

						2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
19.	Dorëzimi i Buxhetit në Ministrinë e Financave	<p>19.1. Buxheti i komunës (i aprovuar në kuvend dhe nënshkruar prej kryesuesit të kuvendit) dërgohet në MF.</p> <p>19.1.1. Bashkëngjitet shkresa përcjellëse nga Kryetari i Komunës për MF.</p> <p>19.1.2. Dorëzohen tabelat buxhetore të zhvilluara nga SMZHB dhe PIP.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tabela 4.1: Plani i ndarjes buxhetore të shpenzimeve. • Tabela 4.2: Financimi i projekteve kapitale. • Tabela 4.3: Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grandet qeveritare dhe të hyrat vetanake. 	1. Kryetari i Komunës	30 shtator	<p>1. Dokumenti i buxhetit në kopje fizike dhe elektronike</p> <p>2. Shkresa përcjellëse</p> <p>3. Tabela 4.1</p> <p>4. Tabela 4.2</p> <p>5. Tabela 4.3</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
Procesi i Menaxhimit të Projekteve						

20.	Autorizimi për planifikim të detajuar dhe realizim të projektit	<p>20.1. Pas aprovimit të projektit nga Kuvendi Komunal, Kryetari i Komunës nxjerr Vendimin e Projektit përmes të cilit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Caktohet Menaxheri i Projekteve; dhe • Autorizohet planifikimi i projektit; <p>20.2. Menaxheri i Projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan aktivitetet e projektit në hollësi; dhe • Përcakton mënyrën e kryerjes së aktiviteteve të projektit. 	1. Kryetari i Komunës	Nuk ka	1. Vendimi i Projektit	<p>1. Manuali për Përdorues – Programi i Investimeve Publike (Programi i Investimeve Publike).</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
21.	Përgatitja e Planit për Menaxhimin e Projektit	<p>21.1. Pas marrjes së vendimit të projektit, Menaxheri i Projekteve bazuar në informatat e marra nga njësia kërkuese përgatitë planin për menaxhimin e projektit i cili përfshinë informatat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fushëveprimin e projektit; • Planin e aktiviteteve; • Buxhetin; • Planin e prokurimit; • Planin e informimit dhe komunikimit me hisedarët; • Planin e menaxhimit të cilësisë; 	1. Menaxheri i Projekteve	Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës	1. Plani për Menaxhimin e Projektit	1. Manuali për Përdorues – Programi i Investimeve Publike (Programi i Investimeve Publike).

		<ul style="list-style-type: none"> • Planin e shfrytëzimit të burimeve njerëzore në projekt; • Planin e menaxhimit të rreziqeve në projekt; dhe • Planin e dorëzimit të projektit tek përfituesi i projektit. 				
		<p style="text-align: center;">KUTIA 2</p> <p>Për projektet zhvillimore përfshihet plani i veprimeve ligjore, aplikimi i lejeve të ndryshme etj. Për projektet që kanë të bëjnë me pasuri përfshihet plani për regjistrimin e asetëve të projektit.</p>				
22.	Prezantimi i planit të projektit tek BDK për aprovim	<p>22.1. Pas përgatitjes së Planit për Menaxhim të Projektit, Menaxheri i Projekteve prezanton planin para BDK.</p> <p>22.2. Nëse BDK pajtohet me projektin, e aprovon realizimin e më mëtejshëm të projektit.</p>	<p>1. Menaxheri i Projekteve.</p> <p>2. BDK.</p>	NA	1. Plani i Menaxhimit të Projektit	NA
23.	Projektimi/specifikimi teknik	<p>23.1. Pas aprovimit të planit të projektit, fillon finalizimi/specifikimi teknik i outputit (rezultatit) të projektit.</p> <p>23.2. Projektimi/specifikimi teknik pastaj bëhet pjesë e DNPDF-së.</p>	<p>1. Drejtori i drejtorisë përkatëse</p> <p>2. Menaxheri i Projekteve</p>	NA	<p>1. Formulari DNPDF</p> <p>2. Projektimi/specifikimi teknik</p>	1. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – KRPP (2018) (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).

Procesi i shpenzimeve						
24.	Vlerësimi i nevojave dhe aprovimi i kërkesës	<p>24.1. Pas pranimit të kërkesës për shpenzime dhe konfirmimit të alokimit të fondeve, drejtori i drejtorisë (zyrtari autorizues) duke siguruar pikat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Natyrën dhe fushëveprimin e saktë të nevojave që investimi kapital i kërkuar synojnë të arrijë; • Vlerën e parashikuar të projektit kapital, si dhe kushtet materiale të kontratës publike që do t'i nënshtrohet prokurimit të parashikuar; • Specifikat teknike/funksionale të projektit kapital; • Përfitimet e pritura të projektit; dhe • Një deklaratë të qartë se si prokurimi do t'i promovoj objektivat institucionale. <p>24.2. Drejtori nënshkruan pjesën II.1 të Deklaratës të Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve (DNPDF) lidhur me vlerësimin e nevojave.</p> <p>24.3. Drejtori dërgon DNPDF e nënshkruar tek DBF/ZKF për</p>	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse	Nuk ka	<p>1. Kërkesa për inicim të shpenzimeve për investime kapitale në kopje fizike ose</p> <p>2. DNPDF në kopje fizike</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

		kontrollim të disponueshmërisë së fondeve.				
25.	Përgatitja e kërkesës për zotim dhe regjistrimi i zotimit të fondeve në SIMFK	<p>25.1. Pas aprovimit të kërkesës, zyrtari financiar i drejtorisë përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Verifikon nëse fondet janë në dispozicion në linjën e kërkuar buxhetore; • Plotëson të dhënat për Kërkesën e Zotimit për Blerje; • Regjistron kodet e klasifikimi të buxhetit (kodin e fondeve, kodin organizativ, të programit, kodin projektit, funksionit dhe kodin ekonomik); dhe • Nënshkruan dokumentin Kërkesën e Zotimit për Blerje. <p>25.2. Zyrtari zotues pas pranimit të dokumentit Kërkesa e Zotimit për Blerje regjistron:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat në SIMFK, nga ku vetë sistemi kryen kontrollin automatik nëse ka fonde të mjaftueshme në linjën e kërkuar buxhetore dhe fondet e kërkuara zotohen për obligimet e ardhshme dhe datat e mundshme të pagesave. 	<p>1. DBF/ZKF</p> <p>2. Zyrtari financiar</p> <p>3. Zyrtari zotues</p>	Tre ditë pas pranimit të dokumentacionit	<p>1. Kërkesa e zotimit për blerje (kopje fizike).</p> <p>2. Kërkesa për investime kapitale (krijuar në SIMFK moduli i blerjeve dhe të nënshkruar nga zyrtari zotues).</p> <p>3. DNPDF pranuar nga DBF/ZKF.</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

		25.3. Nëse fondet nuk zotohen, procesi ndalet dhe i dërgohet Kryetarit të Komunës.				
		25.4. Nëse fondet zotohen, DNPDPF (në kopje fizike) dërgohet tek zyra e prokurimit përmes DBF/ZKF-së.				
Procesi i Prokurimit						
26.	Përgatitja e dosjes së tenderit	26.1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit dorëzon lëndën tek zyrtari i prokurimit për përgatitje të dosjes së tenderit bazuar në dokumentacionin e siguruar nga njësia kërkuese (drejtoria përkatëse) sipas specifikave teknike, etj.	1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit 2. Drejtori i Drejtorisë Përkatëse	Nuk ka	1. Dosja e Tenderit	1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) 2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).

27.	Publikimi i njoftimit për kontratë	27.1. ZP bën publikimin e njoftimit për kontratë në portalin e e-prokurimi të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik KRPP.	1. Zyrtari i prokurimit	Nuk ka	1. Njoftimi për Kontratë	<p>1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
28.	Pranimi i ofertave nga operatorët ekonomik dhe përgjigjet në pyetjet e pranuar	<p>28.1. Të gjitha pyetjet eventuale të operatorëve ekonomik dhe përgjigjet nga autoriteti kontraktues bëhen përmes portalit e-prokurimi.</p> <p>28.2. Kërkesa për dosje të tenderit dhe dorëzimi i dosjes tek operatori ekonomik bëhet përmes portalit e-prokurimit.</p>	1. Zyrtari i Prokurimit	Nuk ka	1. Komunikimi në e-prokurim	<p>1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për</p>

						Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).
29.	Emërimi i anëtarëve të komisionit të hapjes	29.1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit cakton anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve dhe e përcjell tek anëtarët e komisionit.	1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit 2. Komisioni i hapjes së tenderëve	Para publikimit të Njoftimit për kontratë	1. Vendimi për emërimin e anëtarëve të komisionit të hapjes	1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) 2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).
30.	Hapja e tenderëve	30.1. Komisioni i hapjes mbledhet dhe bën hapjen e të gjithë tenderëve të pranuar brenda afatit të caktuar në dosjen e tenderit.	1. Komisioni i hapjes së tenderëve	Menjëherë pas përfundimit të afatit të	1. Hapja përmes sistemi elektronik të	1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e

				pranimet të tenderëve	prokurimit publik	Republikës së Kosovës 2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).
31.	Emërimi i anëtarëve për komision të vlerësimit	31.1. Pas hapjes së tenderit, anëtarët e komisionit të vlerësimit emërohen nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit. 31.2. Vendimi i dërgohet të gjithë anëtarëve të komisionit.	1. Kryetari i Komunës	Brenda 48 orëve pas hapjes së tenderëve dhe zgjatë jo më shumë se 30 ditë pas fillimit të vlerësimit	1. Vendimi për caktimin e komisionit vlerësues të tenderëve	1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) 2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

						2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).
32.	Vlerësimi i tenderëve	<p>32.1. Komisioni i vlerësimit të tenderëve mbledhet dhe bën vlerësimin e tenderëve sipas kriterëve dhe kërkesave të dosjes së tenderit.</p> <p>32.2. Komisioni pas përfundimit të procedurave të vlerësimit krijon raportin e vlerësimit me anë të të cilit i rekomandon zyrtarit përgjegjës të prokurimit cila operator ekonomik duhet të shpërblehet me kontratë.</p>	1. Komisioni i vlerësimit të tenderëve	<p>1. Vlerësimi fillon menjëherë pas hapjes dhe jo më vonë se 5 dite pas hapjes së tenderëve</p> <p>2. Vlerësimi i ofertave përfundon jo më vonë se 30 ditë nga hapja</p> <p>3. Në raste të jashtëzakonsh me afati mund të zgjatet edhe për 20 ditë shtesë</p>	<p>1. Vendimi për caktimin e komisionit vlerësues të tenderëve</p> <p>2. Raporti i vlerësimit të tenderëve</p>	<p>1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
33.	Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues	33.1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit nxjerr njoftim për vendimin e autoritetit kontraktues në sistem elektronik të prokurimit i cili shihet nga pjesëmarrësit në prokurim	<p>1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit</p> <p>2. Kryetari i Komunës</p>	Pas rekomandimit për dhënie të kontratës	1. Vendimi i autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës	1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e

		33.2. Në këtë fazë bëhet ri-konfirmimi i fondeve përmes DNPDP pjesa e III-të	3. DBF/ZKF		2. Ri-konfirmimi i DNPDP	Republikës së Kosovës 2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).
34.	Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim në komunë	34.1. Operatorët ekonomik të pa kënaqur, mund të parashtrajnë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues brenda 5 ditëve nga publikimi i njoftimit për vendimin të autoritetit kontraktues. 34.2. Nëse paraqitet kërkesa për rishqyrtim, procedura e prokurimit pezullohet dhe të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë njoftohen.	1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit	Brenda 5 ditëve pas datës së njoftimit të OE mbi rezultatet e prokurimit	1. Ankesa nga operatorët ekonomik	1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) 2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni

		<p>34.3. Pezullimi i procedurës përfundon menjëherë pasi komuna të merr vendim për kërkesën për rishqyrtim.</p> <p>34.4. Komuna shqyrton kërkesën e operatorit ekonomik brenda 3 ditëve punë respektivisht 6 ditëve nga pranimi i saj.</p> <p>34.5. Komuna, mund, me anë të një vendimi:</p> <p>34.5.1. Të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazë; ose</p> <p>34.5.2. Të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar.</p> <p>34.6. Vendimi i komunës është i detyrueshëm për komunën dhe duhet të zbatohet menjëherë.</p> <p>34.7. Vendimi i komunës i komunikohet në formë elektronike parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara pjesëmarrës në prokurimin në fjalë e shohin atë në sistem elektronik të prokurimit të Kosovës.</p>				Rregullativ i Prokurimit Publik .
--	--	---	--	--	--	---

35.	Paraqitja e ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)	<p>35.1. Në rast se operatori ekonomik nuk është i kënaqur me vendimin e marrë nga komuna, mund të parashtroj ankesë pranë OSHP-së.</p> <p>35.2. Ankesa duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga komuna në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.</p> <p>35.3. Dorëzimi i ndonjë ankesë e obligon komunën që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit.</p> <p>35.4. OSHP jep përgjigje ndaj ankesës brenda 34 ditëve nga pranimi i ankesës.</p> <p>35.5. OSHP mund të vendos/kërkoj:</p> <p>35.5.1. Ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve;</p> <p>35.5.2. Të rekomandoj autoritetit kontraktues të vazhdoj me dhënien e kontratës.</p>	1. OSHP	Brenda 10 ditëve pas datës së njoftimit të OE me letrën standarde mbi rezultatet e prokurimit	1. Ankesa nga operatorët ekonomik 2. Vendimi i OSHP-së	<p>1. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
-----	--	--	---------	---	---	--

36.	Nënshkrimi i kontratës	<p>36.1. Zyrtari përgjegjës nënshkruan kontratat për mallra dhe shërbime deri në 125,000 EUR dhe kontratat për punë deri në 500,000 EUR.</p> <p>36.2. Kontratat me vlera të mëdha (mbi 125,000EURO respektivisht 500,000 EUR) nënshkruhen nga Zyrtari përgjegjës dhe Kryetari i Komunës.</p>	<p>1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit</p> <p>2. Kryetari i Komunës</p>	Pas skadimit të afatit të ankesave	1. Kontrata e nënshkruar	<p>1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
37.	Publikimi i njoftimit për nënshkrim të kontratës	37.1. Më së largu 2 ditë nga nënshkrimi i kontratës, Menaxheri i Prokurimit publikon njoftimin për nënshkrim të kontratës përmes sistemit elektronik të prokurimit publik të Kosovës	1. Menaxheri i Prokurimit	2 ditë nga nënshkrimi i kontratës	1. Njoftimi për dhënie të kontratës	<p>1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për</p>

						Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik)
38.	Dërgimi i kontratës dhe anekseve tek njësia e kërkesës	38.1. Zyrtari përgjegjës i dërgon një ekzemplar të kontratës tek njësia kërkuese, ZKF dhe menaxheri i kontratës.	1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit	Nuk ka	1. Kontrata e nënshkruar	1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) 2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).
Procesi i Menaxhimit të Kontratave						
39.	Caktimi i Menaxherit të	39.1. Pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës, Kryetari i Komunës	1. Kryetari i Komunës	Pas nënshkrimit të kontratës	1. Vendimi për caktimin e MEK	1. Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta

	<p>Ekzekutimit të Kontratës (MEK)</p>	<p>cakton MEK sipas propozimit të drejtorit të drejtorisë përkatëse.</p> <p>39.2. Përgjegjësitë kryesore të MEK janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dakordon planin e menaxhimit të kontratës me Operatorin Ekonomik; • Verifikon nëse punët e kryera janë në përputhje me kontratën dhe specifikimin teknik; • Nënshkruan ditarin e punëve dhe librin ndërtimor në vend-punishte; • Pranon materialin e përfshirë në formularin e komisionit për pranim të materialit dhe sipas specifikimit teknik të kontratës; dhe • Raporton (a) çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës; <div data-bbox="607 949 1084 1163" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px;"> <p style="text-align: center;">KUTIA 1</p> <p>Sipas nevojës, menaxheri i projektit mund të ushtrojë njëkohësisht edhe funksionin e Menaxherit të Ekzekutimit të Kontratës (MEK)</p> </div> <p>dhe (b) çdo ndryshim në kushtet e kontratës, ose para ose gjatë periudhës së zbatimit, të cilat do të kishin ndikuar në vlerësimin dhe radhitjen e tenderëve dhe ne</p>	<p>2. MEK</p> <p>3. Drejtori i Drejtorisë përkatëse</p>		<p>2. Plani i Menaxhimit të Kontratës</p> <p>3. Raportet e progresit të projekteve</p> <p>4. Nënshkrimi i ditarit dhe librit ndërtimor</p>	<p>Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
--	---------------------------------------	---	---	--	--	---

		<p>përzgjedhjen e operatorit ekonomik.</p> <p>39.3. Pas dakordimit të Planit të Menaxhimit të Kontratës, MEK dërgon kërkesë tek menaxheri i projektit dhe drejtori i drejtorisë përkatëse për hapjen e urdhëresës së punës.</p>				
40.	Hapja e urdhëresës së punës dhe caktimi i Mbikëqyrësit Ekzekutiv të Urdhëresës (MEU)	<p>40.1. Pas pranimit të kërkesës për hapjen e urdhëresës së punës nga MEK, Kryetari i Komunës në konsultim me drejtorin e drejtorisë përkatëse cakton Mbikëqyrësin Ekzekutiv të Urdhëresës (“MEU” ose “mbikëqyrësi”).</p> <p>40.2. Përgjegjësitë kryesore të MEU janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në baza të rregullta, nënshkruan ditarin e punëve dhe librin ndërtimor në vend-punishte; • Merr pjesë në vend-punishte gjatë kryerjes së punëve nga operatori ekonomik (punë kryerësi); • Siguron që punët e kryera janë ato të përfshira në urdhëresën e punëve; • Raporton tek MEK për problemet eventuale gjatë implementimit të punëve; dhe 	1. MEU	Pas hapjes së urdhëresës për punë	<p>1. Vendimi për caktimin e MEU-së</p> <p>2. Urdhëresa e punës</p> <p>3. Raporti tek MEK (në rast të nevojës)</p>	<p>1. Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>

		<ul style="list-style-type: none"> Për vonesa në kryerjen e punëve raporton tek MEK dhe drejtori i drejtorisë përkatëse; 				
		<p>KUTIA 2</p> <p>Mbikëqyrja e projekteve mund të bëhet nga stafi brenda komunës ose të kontraktohet tek ndonjë operator ekonomik nga jashtë.</p>				
41.	Pranimi cilësor i materialeve ndërtimore para fillimit të punimeve (sipas nevojës)	<p>41.1. MEK ose Menaxheri i Projektit njoftojnë drejtorin e drejtorisë përkatëse për sjelljen e materialit teknik nga ana e kontraktorit në depo të tyre.</p> <p>41.2. Drejtori i drejtorisë përkatëse, formon një Komision të Pranimit të Materialit (KPM) në përbërje prej 3 ose 5 anëtarëve.</p> <p>41.3. KPM kontrollon cilësinë e materialit nëse është në përputhje me specifikat teknike të kontratës dhe aprovon përdorimin e materialit.</p>	1.MEK/Menaxheri i Projektit	Pas njoftimi të OE për sjellje të materialeve në depo të tyre	<p>1. Vendimi për caktimin e KPM</p> <p>2. Formulari Pranimi Cilësor i Materialit</p>	<p>1. Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
Nën-procesi aneks kontratat për punët shtesë dhe/ose të pa parapara (opsionale)						
42.	Inicimi i punëve shtesë dhe përshkrimi i	42.1. Mbikëqyrësi i ekzekutimit të kontratës vlerëson nevojën për punë shtesë ose punë të pa parapara.	1. Mbikëqyrësi i Ekzekutimit të Kontratës (MEK)	Nuk ka	1. Formulari Kërkesa për	1. Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e

	<p>specifikacionit teknik</p>	<div data-bbox="591 236 1079 571" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; margin-bottom: 10px;"> <p style="text-align: center;">KUTIA 3</p> <p>Punët e pa parapara mund të jenë rezultat i ndonjë force madhore ose projekti/specifikimi teknik jo cilësor.</p> <p>Punët shitesë janë zakonisht rezultat i drejtpërdrejtë i kërkesave të reja nga sponsori si pasojë e pozicioneve të pa parapara me projekt etj.</p> </div> <p>42.2. Nëse punët shitesë/të pa parapara ndikojnë në projektin origjinal respektivisht kërkojnë rishikim të lejes fillestare, atëherë ndryshimet duhet të inkuorohen në projektin origjinal si dhe të sigurohen lejet e ndërtimit nga institucionet kompetente.</p> <p>42.3. Nëse punët shitesë/të pa parapara vlerësohen si të nevojshme, MEK bën kërkesë për punë shitesë tek menaxheri i projektit.</p> <p>42.4. Menaxheri i projektit së bashku me MEK përgatitë raport të detajuar për punët shitesë ose punë të pa parapara përshtirë specifikimin teknik.</p>	<p>2. Menaxheri i Projektit</p>		<p>ndryshime për punë shitesë.</p> <p>2.Specifikacioni teknik i punëve shitesë</p>	<p>Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik)</p> <p>3. Ligji Nr. 04/L-110 Për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>
--	-------------------------------	--	---------------------------------	--	--	--

		42.5. Menaxheri i projektit dërgon raportin për aprovim tek Kryetari i Komunës.				
43.	Aprovimi i punëve shtesë	<p>43.1. Raporti i detajuar për punët shtesë aprovohet nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë përkatëse dhe DBF/ZKF:</p> <p>43.1.1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse, DBF/ZKF dhe Kryetari i Komunës.</p> <p>43.2. Pas aprovimit, raporti i aprovuar dërgohet zyrës së prokurimit për procesim të mëtejshëm.</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. BDK</p>	Nuk ka	1. Aprovimi i punëve shtesë	<p>1. Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).</p>
44.	Nënshkrimi i aneks-kontratës	<p>44.1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit harton aneks kontratën, pasi që të njofton KRPP-ne.</p> <div data-bbox="622 997 1086 1214" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; text-align: center;"> <p>KUTIA 4 Aneks kontratat nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% të vlerës bazë të kontratës.</p> </div> <p>44.2. Aneks kontrata nënshkruhet nga Zyrtari përgjegjës dhe operatori ekonomik.</p>	<p>1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit</p> <p>2. Kryetari i Komunës</p> <p>3. Operatori ekonomik</p>	Pas aprovimit të punëve shtesë	1. Aneks kontrata e nënshkruar	<p>1. Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurimin Publik 2018 (Komisioni</p>

		44.3. Aneks kontratat me vlerë mbi 500,000 Euro, nënshkruhen edhe nga Kryetari i Komunës.				Rregullativ i Prokurimit Publik).
Procesi i Shpenzimeve						
45.	Krijimi i urdhërblerjes	<p>45.1. Pas nënshkrimit të kontratës/regjistrimit të të dhënave bankare të furnitorit në Thesar, menaxheri i kontratës i lëshon operatorit ekonomik letrën e fillimit të punëve (urdhërblerjen).</p> <p>45.2. Menaxheri i kontratës siguron nënshkrimin e furnitorit në urdhërblerje për ri konfirmimin e afateve për kryerjen e shërbimeve apo ofrimin e mallrave.</p>	1. Menaxheri i kontratës	Brenda tri ditëve pas nënshkrimit të kontratës	1. Urdhërblerja nga SIMFK	<p>1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

						3. Procedura e Thesarit për rregullat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
46.	Pranimi i faturës	46.1. Fatura pranohet përmes protokollit të zyrës së financave respektivisht (zyrtari përgjegjës për pranim të faturave).	1. Zyrtari i pranimit të faturave	Nuk ka	1. Fatura e protokolluar	Nuk ka
47.	Pranimi i punëve të kryera	47.1. Për investime kapitale të njehershme (furnizim me pajisje, blerje, vetura, etj.), Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë përkatëse formon komision të pranimit. 47.2. Komisioni i pranimit bën pranimin fizik të pasurive kapitale (pajisjeve, veturave, etj.) dhe përpilon raport të pranimit. 47.3. Për projektet kapitale “punë” menaxheri i kontratës/projektit së bashku me organin mbikëqyrës (brenda ose jashtë komunës) bëjnë	1. Komisioni për pranim të mallrave 2. Menaxheri i Kontratës / Projektit 3. Organi Mbikëqyrës 4. Komisioni i Pranimit Teknik	Sipas nevojës	1. Procesverbali i komisionit (në letër) 2. Raporti i situacioneve 3. Raporti përfundimtar i punëve të kryera 4. Kërkesa e operatorit ekonomik për	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<p>monitorimin e implementimit të projektit.</p> <p>47.4. Menaxheri i projektit së bashku me mbikëqyrësin bëjnë pranimin e punëve ose situacioneve të kryera (sipas situacioneve të aprovuara paraprakisht).</p> <p>47.5. Në rast të përfundimit të projekteve, përpilohet një raport i punëve të kryera nga komisioni i pranimit teknik të përkohshëm të punëve.</p> <p>47.6. Pranimi i punëve bëhet nga komisioni i pranimit teknik që caktohet nga Kryetari i Komunës bazuar propozimin e drejtorit të drejtorisë përkatëse.</p> <p>47.7. Kërkesa për pranim të punëve iniciohet nga operatori ekonomik përmes menaxherit të kontratës i cili kërkesën e përcjell tek drejtoria përkatëse.</p> <p>47.8. Komisioni i pranimit teknik:</p>			pranim të punëve	
--	--	---	--	--	------------------	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Kontrollon nëse sasia, cilësia, e punëve të kryera janë në përputhje me kontratën (specifikat teknike dhe afatin kohor etj.); • Krahason nëse situacionet përputhen me urdhërblerjen, faturën etj.; dhe <p>47.9. Nëse punët e kryera nuk përputhen me kontratën, komisioni për pranimit të teknik nuk i pranon punët dhe propozon korrigjimet e nevojshme nga operatori ekonomik.</p> <p>47.10. Nëse Komisioni pranon punët pa vërejtje, atëherë, komisioni përpilon një raport të pranimit që nënshkruhet nga kryetari i komisionit, anëtarët dhe organi mbikëqyrës dhe e dërgon tek zyra për buxhet dhe financa dhe zyra e prokurimit.</p> <p>47.11. Pas përfundimit të periudhës së garancionit të cilësisë së punëve (zakonisht 1 vjeçar apo më gjatë), bëhet pranimi përfundimtar i punëve të punëve.</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		47.12. Komisioni i pranimit përfundimtar të punëve bën pranimin përfundimtar të punëve në teren dhe përpilon raportin përfundimtar të punëve.				
48.	Regjistrimi i pranimit të punëve në SIMFK	48.1. Zyrtari përgjegjës për pranim e punëve regjistron kryerjen e punëve/blerjen e pajisjeve/pasurive në SIMFK. 48.2. Zyrtari përgjegjës për pranimin e punëve dërgon raportin e pranimit të nxjerrë nga SIMFK dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës të zyrtari shpenzues.	1. Zyrtari për pranim në SIMFK.	Nuk ka	1. Raporti i pranimit të punëve i nënshkruar në SIMFK	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 3. Procedura e Thesarit për rregullat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
49.	Regjistrimi i pasurive të blera	49.1. Për blerje të pajisjeve, zyrtari i pasurive pranon nga zyrtari i depos dokumentin për pasuritë e blera. 49.2. Zyrtari i pasurisë, siguron nënshkrimin sërish nga drejtori	1. Zyrtari i pasurisë 2. Zyrtari i depos	Nuk ka	1. Për pajisje, krijohen barkodet nga e-pasuria të cilat vendosen në të gjitha pajisjet.	1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta

		<p>përkatës dhe zyrtari i logjistikës për çdo pasuri afatgjate.</p> <p>49.3. Për punët e kryera, zyrtari i pasurisë siguron dokumentacionin nga komisioni i pranimit teknik dhe regjistron të gjitha pasuritë fizike në regjistrin e pasurive kapitale mbi 1,000 EUR.</p> <p>49.4. Ruan shënimet rreth vendndodhjes dhe personat e ngarkuar për çdo pasuri.</p>				<p>Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Procedura e Thesarit për rregullat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>3. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 2 - Delegimi i Përgjegjësive (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>4. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 5 - Menaxhimi i Pasurive (Ministria e Financave –</p>
--	--	---	--	--	--	--


						Procedurat e Thesarit).
50.	Aprovimi i pagesës	50.1. Pas kontrollimit të dokumentacionit financiar, zyrtari certifikues aprovon lëndën për pagesë.	1. Zyrtari certifikues	NA	1. Aprovimi në SIMFK.	<p>1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>


						<p>3. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat</p> <p>(Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>4. Procedura e Ministrisë së Financave për të drejtat e qasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p>
51.	Kryerja e pagesës	51.1. Divizioni i pagesave në thesar kontrollon likuiditetin në Llogarinë e Vetme e Thesarit (LLVTh) dhe realizon pagesat nga LLVTh.	1. Thesari	Brenda tri ditëve	1. Paga elektronike nga Thesari.	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

						2. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
52.	Barazimi i të dhënave me LLVTH	<p>52.1. Banka Qendrore e Kosovës (BQK), gjeneron pasqyrën bankare elektronike dhe një raport të pagesave të gabuara;</p> <p>52.2. Thesari komunikon me DBF/ZKF të komunës për pagesat e gabueshme dhe nga të cilët kërkohet të korrigjon dosjet më së largu deri në ditën e tjetër të punës.</p>	<p>1. Thesari</p> <p>2. BQK</p>	Brenda ditës së nesërme	1. Komunikimi me e-mail me DBF/ZKF	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p>
53.	Raportimi i pagesave	<p>53.1. Zyrtari përgjegjës i kontabilitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijon raporte për të pagueshmet dhe të arkëtueshmet, pagesat; dhe 	1. Zyrtari përgjegjës i kontabilitetit	Pagesat bëhen brenda 30 ditëve nga data	1. Raportet ditore për llogaritë e pagueshme	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148

		<ul style="list-style-type: none"> • Krijon një bazë të të dhënave për pagesat e kryera. 		e pranimit të faturës	<p>2. Pagesat në SIMFK</p> <p>3. Data bazat në Excel apo format tjetër</p>	<p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 - Autorizimi dhe Pagesat (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p>
Fundi i procesit të integruar të investimeve kapitale						

3. PROCESI I INTEGRUAR I INVESTIMEVE KAPITALE: DIAGRAMI I PROCESIT





XI. PROCESI I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE

1. PROCESI I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i Menaxhimit të Projekteve
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<DATA>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të menaxhimit të projekteve kapitale në komunë duke filluar prej fazave të hershme si konceptimi, inicimi dhe planifikimi, realizimi, përmbyllja dhe përdorimi.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
Versioni:	V.01/2018
Korniza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048. 2. Ligji Nr. 04.L-042 për Prokurimin Publik. 3. Manuali për Përdorues – Programi i Investimeve Publike 4. Rregullat dhe Operativ për Prokurimin Publik (2018).
Pronari i Procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës 2. Zyra e Menaxhimit të Projekteve ose Drejtorët e Drejtorisë
Palët e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuvendi Komunal dhe Kryesuesi 2. Kryetari i Komunës 3. Bordi i Drejtorëve për Portfolio të Projekteve (BDPP) 4. Bordi i Drejtorëve të Komunës 5. Zyra për Menaxhim të Projekteve/Menaxheri i Projekteve 6. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar Komunal 7. Drejtorët e Drejtorive Komunale 8. Zyrtar përgjegjës i prokurimit 9. Menaxheri i Ekzekutimit të Kontratës
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi Programi i Investimeve Publike (PIP) 2. E-Mail
Dokumentet e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Korniza Afatmesme e Buxhetit 2. Formulari për projekt ide 3. Projekt ideja 4. Projekt propozimi 5. Kërkesa për buxhet (Tabelat e buxhetit 4.2 Lista e Projekteve me Prioritet) 6. Lista e propozimeve dhe ideve nga dëgjimet publike 7. Vendimi i Projektit 8. Plani për Menaxhimin e Projektit 9. Formulari i DNPDPF 10. Projekti ose/dhe specifikimet teknike

	<ul style="list-style-type: none"> 11. Formulari për pranimin e cilësisë së mallit 12. Formulari për përmbushje të kontratës 13. Raporti përfundimtar i projektit 14. PCF 1, 2, 3, 4 (4.1, 4.2, 4.3)
Ndërlidhja:	<ul style="list-style-type: none"> 1. Procesi i Shpenzimeve për Investime Kapitale 2. Procesi i Prokurimit 3. Procesi i Menaxhimit të Kontratave
Numri i hapave:	15

2. PROCESI I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE: PROCESI NË DETAJ

Përshkrimi i procesit të menaxhimit të projekteve						
Hapat	Aktivitetet	Aktivitetet e kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet e gjeneruara	Korniza ligjore
	Faza 1: Konceptimi					
1	Përcaktimi i prioriteteve strategjike të komunës	<p>1.3 Kryetari i Komunës përcakton prioritetet strategjike të cilat përfshihen në Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB) në përputhje me politikat dhe prioritetet qeveritare.</p> <p>1.4 Zyrtari përgjegjës i komunës i përshkruan prioritetet strategjike në Sistemin Programi i Investimeve Publike (PIP).</p>	1. Kryetari i Komunës	Para fillimit të vitit	1. KAB	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
2	Zhvillimi i projekt idesë	<p>2.1 Menaxheri i Projekteve, në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të njësisë kërkuese zhvillojnë projekt idenë themelore.</p> <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px; margin-top: 10px;"> <p style="text-align: center; margin: 0;">KUTIA 1</p> <p style="margin: 0;">Projekt ideja mund të zhvillohet si rezultat i kërkesës nga qytetarët, shoqëria civile, komuniteti profesional, prioritetet e komunës etj.</p> </div>	1. Zyrtari përgjegjës i projekteve	NA	1. Formulari për Projekt Ide	1. Manuali për Përdorues – Programi i Investimeve Publike (Programi i Investimeve Publike)

		2.2 Projekt ideja preliminare duhet të përmbajë informatat për mbështetje të projekt idesë siç janë: <ul style="list-style-type: none"> • Arsyeshmërinë; • Përfitimet dhe kostot e mundshme; • Datën e fillimit dhe përfundimit; dhe • Informata rreth sponsorit dhe iniciuesit të projektit. • Etj. 				
3	Prezantimi i projekt idesë në Bordin e Drejtorëve në Komunë (BDK) për aprovim	3.1 Zyrtari përgjegjës për projekte së bashku me drejtorin e drejtorisë përkatëse prezantojnë idenë në Bordin e Drejtorëve të Komunës (BDK). 3.2 Nëse projekt ideja aprovohet, fillohet me përgatitjen e projekt propozimit.	1. Zyrtari përgjegjës për projekte 2. BDK	Nuk ka	1. Projekt ideja 2. Procesverbalet ku jepet pëlqimi	NA
